



safejournalists.net

Tregues i Nivelit të Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor

Raporti përshkrues për Shqipërinë 2022

PËRMBAJTJA

MJEDISI LIGJOR DHE ORGANIZATIV

11

PARANDALIMI I DUHUR

29

PROCESI I RREGULLT

43

SIGURIA AKTUALE

53

Hyrje

Treguesi i Nivelit të Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor (Treguesi) është një instrument hulumtimi i hartuar për të matur dhe monitoruar ndryshimet në mjediset përkatëse sociale dhe politike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ndryshime që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në sigurinë e gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të mediave gjatë ushtrimit të profesionit. Ky tregues mbështetet në të dhënat kërkimore të mbledhura dhe të analizuar nga partnerët e Platformës [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) sipas një procedure rigoroze hulumtimi. Të dhënat e mbledhura për dimensione të ndryshme të konceptit kompleks të "sigurisë së gazetarëve" janë analizuar në aspektin sasior dhe përmbledhur në një tregues të përbërë - Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve - për të matur ndryshimet në të shtatë vendet e Ballkanit Perëndimor në këtë periudhë. Bazuar në të dhënat kërkimore, nëntë anëtarë të Panelit Këshillimor në secilin vend¹ bënë një vlerësim të situatës dhe dhanë pikët e tyre për secilin nga 19 treguesit e dimensioneve të mëposhtme:

- (1) **Mjedisi ligjor dhe organizativ** – ekzistenca dhe zbatimi i masave mbrojtëse ligjore të rëndësishme për sigurinë e gazetarëve;
- (2) **Parandalimi i duhur** – ekzistenca dhe zbatimi i një sërë masash parandaluese që kanë efekte të drejtpërdrejta në mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve;
- (3) **Procesi i rregullt** – sjellja e institucioneve shtetërore dhe zyrtarëve publikë ndaj gazetarëve dhe efikasiteti i sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me hetimin e kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve;
- (4) **Siguria aktuale** – incidente dhe raste të formave të ndryshme të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve dhe mediave.

Treguesi i Nivelit të Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor u hartua bashkërisht nga studiuesit e Institutit RESIS² me qendër në Shkup dhe partnerët e Platformës


¹ Në Shqipëri, Paneli Këshillimor përbëhej nga: Dorentina Hysa, Eda Noçka, Elira Çanga, Elvin Luku, Erjon Curraj, Gjergj Erebara, Ilda Londo, Lutfi Dervishi dhe Orkidea Xhaferaj.
² Kuadrin konceptual për Indeksin dhe modelin e agregimit, ponderimit dhe llogaritjes së tij e hartuan studiuesit e Institutit RESIS (www.resis.mk), Snezana Trpevska, Igor Micevski and Ljubinka Popovska Tosheva.

Safejournalists.net, dhe Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Serbisë, Shoqata e Gazetarëve të Bosnje dhe Hercegovinës, Sindikata e Mediave të Malit të Zi, Asociacioni i Gazetarëve të Maqedonisë së Veriut, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Shoqata e Gazetarëve Kroatë dhe një hulumtuese e pavarur në Shqipëri³. Si i tillë, ky tregues është rezultat i përpjekjeve të përbashkët të Platformës Safejournalists.net dhe mbulon të gjitha çështjet specifike që partnerët lokalë i identifikuan si të rëndësishme për kontekstin e vendit të tyre.

Viti 2020 ishte viti i parë (viti pilot) për hartimin e kuadrit konceptual dhe metodologjisë për pikëzimin, agregimin dhe llogaritjen e Indeksit. Ky raport i referohet situatës në Shqipëri për vitin 2022 dhe në të evidentohen përmirësimet apo përkeqësimi i situatës lidhur me katër dimensionet duke marrë në konsideratë vlerësimin për vitin 2021 si vit reference. Për më shumë hollësi rreth kuadrit teorik dhe procedurës së ndërtimit dhe llogaritjes së Treguesit dhe të gjitha raportet e vendit mund të vizitoni adresën: (<https://safejournalists.net/safety-index/>).

3 Blerjana Bino si hulumtuese e pavarur e platformës Safejournalists.net në Shqipëri.

TREGUESI I SIGURISË
SË GAZETARËVE



	2021	2022		Zhvillimet e reja kryesore në çdo dimension
I. Mjedisi ligjor dhe organizativ	3,25	3,27	↓	Në vitin 2022, qeveria shqiptare u tërhoq nga miratimi i një pakete të diskutueshme kundër shpifjes. Ligjet që mbrojnë konfidencialitetin e burimeve të gazetarëve u respektuan, ndërkohë që nuk u regjistrua asnjë rast i zbulimit të burimit. Gjithsesi, sfidat ligjore që lidhen me shpifjen, gjuhën e urrejtjes, të drejtën e autorit, privatësinë e individit si dhe me ligjet për mbrojtjen e të dhënave vazhduan. Nuk ka pasur ndryshime të mëdha për sa i përket statusit zyrtar apo licencimit të gazetarëve.
II. Parandalimi i duhur	2,99	2,95	↓	Në vitin 2022, Shqipëria ka bërë përparim të vogël në drejtim të përmirësimit të mekanizmave të raportimit për kërcënimet ndaj gazetarëve por ndihma juridike nuk u ofrohej rregullisht këtyre të fundit. Edhe pse reagimi i policisë ishin i kënaqshëm për sa i përket regjistrimit të rasteve, trajtimi i tyre ishte i ngadaltë dhe joefikas. Deklaratat publike për të dënuar kërcënimet ndaj gazetarëve ishin sporadike dhe pavarësisht disa trajnimeve të policisë, problematikat, të tilla si ndalimet e pajustificuara, vazhduan.
III. Procesi i rregullt	2,60	2,60	–	Në vitin 2022, problemet e vazhdueshme me hetime të ngadalta, shpesh të pushuara, për sulmet fizike ndaj gazetarëve përbëjnë shqetësim në drejtim të efektivitetit të organeve të zbatimit të ligjit. Në Shqipëri nuk ka një sistem të unifikuar për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve.
IV. Siguria aktuale	2,78	2,78	–	Në vitin 2022, rastet e kërcënimit të jetës së gazetarëve nuk ishin sistematike. Janë raportuar nëntë raste të sulmeve fizike ndaj gazetarëve. Problemet strukturore, si lidhjet e politikës dhe biznesit me median, mungesa e transparencës së financimit, shantazhi ndaj mediave, konflikti i interesave, pluraliteti i kufizuar i mediave dhe aksesit i kufizuar në informacion, rritja e numrit të rasteve me informacione të rreme dhe kushtet e këqija të punës, vazhduan të ishin kërcënim ndaj mjedisit për gazetari cilësorë të pavarur.
Treguesi i Sigurisë së Gazetarëve	2,85	2,84	↓	

— PËRMBLEDHJE

I. MJEDISI LIGJOR DHE ORGANIZATIV

- Në vitin 2022 qeveria shqiptare bëri një hap prapa duke tërhequr ndryshimet e reja ligjore, përfshirë këtu tërheqjen e plotë të një pakete ligjore kundër shpifjes. Kështu, mjedisi ligjor për shpifjen pati një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2021 duke marrë parasysh tërheqjen nga miratimi në Parlament të paketës anti-shpifje. Sipas Kodit Penal të Shqipërisë, çdo shtetas, përfshirë edhe zyrtarët publikë, ka të drejtë të bëjë kallëzim penal kundër gazetarëve për

shpifje, fyerje ose ndërhyrje në jetën e tyre private. Kodi Civil ka dispozita edhe për dëme jo-pasurore. Pas vendimit të formës së presë të gjykatës, paditësi mund të kërkojë kompensim financiar për fyerje ose publikim të qëllimshëm të informacionit shpifës. Pjesa më e madhe e padive bëhen nga politikanë, biznesmenë dhe përfaqësues të institucioneve publike. Nga analiza e vendimeve gjyqësore të viteve të mëparshme evidentohet se gjobat shumë të rënda dhe të kombinuara me kostot financiare për gazetarët, zvarritjet e procedurave, gjasat për të bërë padi penale, etj., mund të çojnë në autocensurë. Kjo situatë përbën kërcënim për lirinë e shprehjes, veçanërisht në rastet e gazetarëve profesionistë investigativë dhe kritikë.

- Kuadri ligjor i Shqipërisë, konkretisht neni 159 i Kodit të Procedurës Penale, mbështet parimisht të drejtën për të ruajtur konfidencialitetin e burimit, duke e njohur atë si një nga kushtet themelore të lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes. Kjo mbrojtje merr formën e një sekreti profesional, duke përjashtuar kështu gazetarët nga detyrimi për të zbuluar burimet e tyre të informacionit. Pavarësisht kësaj, legjislacioni në fjalë parashikon përjashtime, ku gjykatës i jepet e drejta të urdhërojë në rrethana të caktuara zbulimin e burimit të informacionit. Në vitin 2022 nuk u regjistruan raste të tilla. Po ashtu, në këtë vit nuk pati asnjë ndryshim të dispozitave ligjore që mbrojnë burimet e gazetarëve si dhe nuk u regjistrua asnjë rast ku autoritetet shtetërore të detyronin gazetarët të dorëzonin pajisje elektronike që mund të rrezikonte potencialisht identitetin e burimit. Ky është një përmirësim i dukshëm në krahasim me vitin 2021, ku në një rast të profilit të lartë u bë sekuestrimi i pajisjeve elektronike të një medie. Megjithatë, në vitin 2022 gazetarët, veçanërisht ata investigativë, u përballën sërish me sfida që lidhen krijimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve me burimet e tyre. Shqetësimet në përgjithësi për sigurinë dhe kushtet e paqëndrueshme të punës vazhduan t'i vështirësojnë këto përpjekje, duke sjellë kështu pengesa për lirinë dhe aftësinë e gazetarëve për të ruajtur kontakte me burimet e rëndësishme të informacionit.
- Në Shqipëri, zbatimi i ligjeve të tjera të rëndësishme që lidhen me gazetarët dhe aktorët e medias ka sjellë vështirësi për lirinë dhe sigurinë e tyre. Ligjet që lidhen me shpifjen, gjuhën e urrejtjes, të drejtën e autorit, privatësinë e personit dhe mbrojtjen e të dhënave janë zbatuar në mënyrë selektive, duke kufizuar potencialisht punën e gazetarëve. Në vitin 2022, ka pasur raste kur dispozitat ligjore u imponuan padrejtësisht për të kufizuar përhapjen e informacionit të rrjedhur pas një sulmi kibernetik. Nga ana tjetër, praktikatat e zyrtarëve publikë ku japin përmbajtje të përgatitur paraprakisht që zëvendëson angazhimin e drejtpërdrejtë me gazetarët, kanë ngritur shqetësime për lirinë e medias, marrjen e informacionit dhe transparencën. Ndonëse në vitin 2022 nuk ka pasur raportime për raste

të padive të shumta që synojnë pengimin e hetimeve për korrupsion dhe veprimtari të paligjshme, gazetarët ende përballen me kërcënime dhe kushte të vështira pune. Për më tepër, gazetarët që mbulojnë protestat janë përballur me ndalime të shkurtra të padrejta nga policia dhe janë bërë pre e dhunës dhe ngacmimeve, gjë që ka rrezikuar aftësinë e tyre për të punuar në liri dhe me siguri.

- Në vitin 2022, gazetarëve në Shqipëri nuk u kërkohej licencë për të ushtruar profesionin dhe nuk pati zhvillime të rëndësishme në lidhje me krijimin e një statusi zyrtar për ta. Pati shqetësime në lidhje me akreditimin e mediave nga një institucion i ri i sistemit gjyqësor dhe konsultimet nuk sollën ndryshime të mëdha në rregulloren problematike të këtij institucioni. Gazetarët dhe reporterët e pavarur hasin vështirësi për njohjen e tyre si gazetarë, pasi nga praktikat e deritanishme shpesh lejohen vetëm ata që përfaqësojnë një media tradicionale. Gazetarët në Shqipëri janë të lirë të organizohen dhe të anëtarësohen në shoqata profesionale, pa pengesa të raportuara për vitin 2022. Gjithsesi, në Shqipëri konsolidimi i këtyre shoqatave është ende proces në vazhdim. Nuk pati raste të organizatave mediatike paralele apo të rreme synimi i të cilave është të minojnë shoqatat e vërteta të gazetarëve.
- Edhe në vitin 2022, gazetarët në Shqipëri u përballën me vështirësi të vazhdueshme për sa i përket të drejtave dhe kushteve të punës. Pavarësisht faktit se pjesa më e madhe e tyre kanë kontrata formale pune, ka pasur një përkeqësim të dukshëm të kushteve të punës, veçanërisht në lidhje me vonesat e pagave dhe pushimet e paligjshme nga puna. Gazetarët, veçanërisht ata që punojnë në mediat online, i përjetuan më keq këto problematika. Frika nga reprezaljet dhe solidariteti i pronarëve të mediave u bënë pengesë që gazetarët t'i trajtojnë këto probleme publikisht ose përmes kanaleve institucionale. Kërcënimet ndaj sigurisë dixhitale si hakerimi dhe survejimi i rrezikuan më tej gazetarët, duke theksuar nevojën për përmirësimin e masave të sigurisë kibernetike. Shqetësime të mëdha janë edhe diskriminimi gjinor dhe vështirësitë e lidhura me të, veçanërisht për gratë gazetare.

II. PARANDALIMI I DUHUR

- Në vitin 2022, nuk pati asnjë ndryshim të rëndësishëm për sa i përket institucioneve përkatëse shtetërore në Shqipëri, për krijimin e mekanizmave efikase dhe të specializuara për individët, përfshirë edhe gazetarët, ku të raportohet gjuha e urrejtjes dhe kërcënimet serioze për jetën. Ekziston një numër urgjence pa pagesë (112). Sipas legjislacionit në fuqi, gazetarët dhe punonjësit e medias nuk kanë përfitojnë ndihmë juridike falas apo të përjashtohen nga tarifat gjyqësore. Janë disa OJQ që ofrojnë ndihmë ligjore në mënyrë të pavarur, por skema e tyre nuk ofron mbështetje të qëndrueshme për gazetarët

që kanë nevojë për ndihmë juridike falas. Reagimi i Policisë ndaj kërcënimeve të raportuara në përgjithësi ka qenë i kënaqshëm për sa i përket regjistrimit, por ndjekja e rasteve të raportuara është e ngadaltë dhe joefikase, veçanërisht në rastet e sulmeve online dhe të gjuhës së urrejtjes. Rastet që i kalojnë Prokurorisë shpesh pushohen pa u hetuar fare ose vonohen. Shqetësim është edhe niveli i ulët i raportimit të rasteve nga vetë gazetarët. Veprimet konkrete për të trajtuar sulmet ndaj gazetarëve kanë qenë të kufizuara dhe mekanizmat për llogaridhënien dhe mbledhjen e të dhënave janë të pamjaftueshëm. Ka pasur raste edhe të ndalimeve të paligjshëm dhe pengimit të punës së gazetarëve ku janë përfshirë punonjës të policisë, gjë që nxjerrë në pah vështirësi të tjera me të cilat përballen gazetarët.

- Legjislacioni shqiptar nuk ofron garanci dhe mekanizma të posaçëm mbrojtjeje për sigurinë e gazetarëve dhe të aktorëve të tjerë të mediave që mund të jenë në rrezik. Mekanizmat ekzistues, si p.sh., mekanizmi i mbrojtjes së viktimave, nuk janë përshtatur për nevojat dhe specifikat e sfidave me të cilat përballen gazetarët. Të dhënat e mbledhura për këtë raport tregojnë se në vitin 2022 nuk ka pasur asnjë rast ku gazetarët të jenë regjistruar dhe të kenë përfituar nga mekanizmi i mbrojtjes së viktimave. Megjithatë, ekzistojnë forma të tjera mbështetjeje që janë në dispozicion të gazetarëve, si ndihma juridike falas e ofruar nga organizata të shoqërisë civile në vend dhe ato ndërkombëtare si dhe nga avokatët e lirisë së medias. Me këto forma u ofrohet ndihmë dhe mbrojtje gazetarëve për të kapërcyer sfidat ligjore dhe për garantimin e sigurisë së tyre. Gjithsesi, është ende e nevojshme të krijohen mekanizma sigurie të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura që të trajtojnë posaçërisht rreziqet e pazakonta me të cilat përballen gazetarët dhe aktorët e medias në Shqipëri.
- Ndonëse Shqipëria e ka ratifikuar Konventën e Stambollit dhe i raporton rregullisht Këshillit të Evropës për zbatimin e saj, zbatimi efektiv i kësaj konvente ka ende rrugë të gjatë përpara. Megjithatë, mungesa e të dhënave të ndara sipas rasteve ku viktima të dhunës, kërcënimeve apo ngacmimeve seksuale janë gazetarë femra krijon premisa për minimizimin e fenomenit në sytë e autoriteteve përgjegjëse. Mekanizmat aktualë trajtojnë kryesisht mbështetjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunën me bazë gjinore, por ato janë të fragmentuara, me mangësi në burime dhe të papërshtatura për sfidat dhe kërcënimet me të cilat përballen gazetaret femra në punën e tyre. Shqetësim serioz është ngacmimi seksual duke qenë se gazetaret femra hezitojnë të raportojnë raste të tilla dhe institucioneve u mungojnë kapacitetet e nevojshme për t'u marrë me to.
- Praktika e dënimit publik dhe e distancimit nga kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave nuk është

ende e rregullt dhe e plotë. Edhe pse ka pasur raste kur autoritetet publike kanë dënuar publikisht kërcënime dhe sulme të tilla si shkelja e lirisë së shprehjes, shpeshtësia dhe vazhdimësia e këtyre dënimeve mbeten të kufizuara. Ka ende nevojë të ndërmerret një qasje më sistematike dhe më e rregullt për të dënuar publikisht akte të tilla, duke theksuar seriozitetin e tyre dhe rëndësinë e mbrojtjes së gazetarëve dhe punonjësve të medias.

- Në vitin 2022, janë bërë përpjekje për rritjen e numrit të trajnimeve dhe nivelit të ndërgjegjësimit të punonjësve të policisë në lidhje me ndërveprimin e tyre me gazetarët dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Megjithatë, miratimi i protokolleve zyrtare për të gjithë sistemin mbetet i kufizuar. Edhe pse në përgjithësi zyrtarët shtetërorë janë prirur t'i dënojnë sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve dhe ku policia ka përmirësuar reagimin e saj, kufizimet në kryerjen e hetimeve administrative dhe penale për incidentet vazhdojnë të mbeten. Vihet re një përkeqësim i lehtë në numrin e incidenteve të raportuara në vitin 2022 të shoqërimit të paligjshëm të gazetarëve ose ndalimit të pajustificuar të tyre, konfiskimit të pajisjeve dhe keqtrajtimit të gazetarëve gjatë protestave dhe ngjarjeve të tjera.

III. PROCESI I RREGULLT

- Pavarësisht ndërgjegjësimit në përgjithësi për rëndësinë e mbrojtjes së gazetarëve, në Shqipëri agjencitë e zbatimit të ligjit hasin ende në vështirësi për sa i përket përvetësimit të njohurive, kapaciteteve dhe sigurimit të burimeve për të hetuar me efikasitet sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve. Në Kodin Penal mungojnë dispozita të qarta që të garantojnë mbrojtje të veçantë për profesionin e gazetarëve në rastet e dhunës apo sulmeve të kryera ndaj tyre për shkak të detyrës. Po ashtu, mungesa e protokolleve të posaçme të hetimeve pengon zbulimin dhe ndjekjen efikase penale të personave përgjegjës për agresionin dhe dhunën ndaj gazetarëve.
- Sulmet fizike kundër gazetarëve gjatë viteve të fundit mbeten ende të pazgjidhura dhe hetimet janë të ngadalta dhe joefikase ose pushohen plotësisht. Mungesa e progresit në lidhje me këto hetime ngrë shqetësime për efektivitetin e punës së agjencive të zbatimit të ligjit në trajtimin e sulmeve ndaj gazetarëve. Për më tepër, mungesa e praktikave të rregullta të komunikimit institucional për raste të tilla dhe parimi i sekretit hetimor që është i decentralizuar sipas modelit të punës së secilit prokuror të ngarkuar me hetim kufizojnë edhe më shumë transparencën, pasi procese të tilla marrin shumë kohë, janë të ngadalta dhe informacioni publik për to është i kufizuar.

- Në legjislacionin shqiptar nuk jepet një përkufizim i plotë për ngacmimin, përfshirë edhe ngacmimin online, ndërkohë që ai parashikon mbrojtje vetëm ndaj ngacmimeve seksuale. Autoritetet shtetërore kanë njohuri, kompetenca, burime dhe procedura të kufizuara për trajtimin dhe mbrojtjen efikase të gazetarëve, veçanërisht gazetarëve, nga ngacmimet online. Ky boshllëk në mbrojtjen ndaj ngacmimeve online, i shoqëruar me kulturën e mosreagimit apo mosraportimit të këtyre rasteve, përbën shqetësim të madh për mirëqenien dhe sigurinë e gazetarëve në Shqipëri.
- Në përgjithësi, informacioni për publikun si dhe informacioni që i jepet viktimës apo avokatit të tij/saj në lidhje me ecurinë e çështjes dhe provat e mbledhura gjatë hetimeve është shumë i kufizuar. Kjo vjen për shkak të rregullit të zbatuar me rigorozitet të tepruar nga Prokuroria, pa kritere të mirëpërcaktuara dhe të qarta për sekretin hetimor. Si rezultat, ka shumë pak tregues që të evidentojnë se për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve ndërmerren hetime duke qenë se shumica e rasteve mbeten të pazgjidhura ose hetimet zvarriten, duke dobësuar ndjeshëm efikasitetin e tyre.
- Në Shqipëri mungon një sistem i besueshëm, i unifikuar dhe sistematik i mbledhjes së të dhënave dhe statistikave për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve. Asnjë nga autoritetet përkatëse shtetërore dhe gjyqësore nuk ka krijuar një sistem të besueshëm dhe të unifikuar për mbledhjen e të dhënave, të ndara sipas kritereve të ndryshme. Kjo do të thotë se ka mungesë informacioni të besueshëm dhe të vazhdueshëm në lidhje me incidente të tilla. Po ashtu, institucioneve shtetërore kanë kufizime për sa i përket burimeve dhe kapaciteteve për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla, gjë që dëmton edhe më shumë aftësinë e tyre për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla. Si rezultat, nuk kuptohet mirë shtrirja dhe natyra e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve në vend.


IV. SIGURIA AKTUALE

- Në krahasim me vitin 2021, ka pasur një rritje të lehtë të numrit të rasteve serioze të kërcënimeve dhe ngacmimeve jofizike të raportuara në vitin 2022. Ndërkohë që në vitin 2021 janë raportuar vetëm dy raste serioze, në vitin 2022, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt regjistroi gjithsej 6 raste të tilla.
- Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve bëhen si në mënyrë të fshehtë ashtu edhe haptazi, ndërkohë që vetëm një rast u regjistrua për vitin 2022 në krahasim me disa raste të raportuara për vitin 2021 nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt dhe platforma të tjera ndërkombëtare për lirinë e medias. Megjithatë, raste të tilla nuk janë të vazhdueshme.

- Gjatë vitit 2022 në Shqipëri janë regjistruar nëntë raste të sulmeve aktuale ndaj gazetarëve, ndërkohë po aq janë raportuar edhe në vitin 2021. Gjithsesi, shumica e rasteve të raportuara për vitin 2022 kishin të bënin me ndalimin pa shkak nga Policia dhe pengesa të tjera ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias gjatë raportimit drejtpërdrejtë nga protestat. Ndërsa në vitin 2021, sulmet aktuale lidhen më shumë me individë privatë.
- Për shkak të vështirësive të vazhdueshme, mjedisi për gazetari cilësor, të pavarur dhe vëzhguese në interes të publikut në Shqipëri mbetet mjaft i rrezikuar. Këto vështirësi burojnë nga një sërë problemesh strukturore, përfshirë këtu marrëdhëniet simbiotike mes politikës, biznesit dhe medias, përqendrimi në pak duar i pronësisë së mediave, mungesa e transparencës së burimeve të financimit, përdorimi i mediave për shantazh, konflikti i interesave, pluraliteti i kufizuar i medias, aksesit i kufizuar në informacion, rënia e cilësisë së përmbajtjes që jepet nga mediat, rritja e disinformimit, dhe përkeqësimi i kushteve të punës dhe i të drejtave në punë.

Mjedisi Ligjor dhe Organizativ

3,27



Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimi e tyre nuk prodhojnë efekte frenuese për gazetarët dhe mediat

Pikët për 2021: 2,91 / Pikët për 2022: 3,08

Në vitin 2022 qeveria shqiptare bëri një hap prapa duke tërhequr ndryshimet e reja ligjore, përfshirë këtu tërheqjen e plotë të një pakete ligjore kundër shpifjes. Kështu, mjedisi ligjor për shpifjen pati një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2021 duke marrë parasysh tërheqjen nga miratimi në Parlament të paketës anti-shpifje. Sipas Kodit Penal të Shqipërisë, çdo shtetas, përfshirë edhe zyrtarët publikë, ka të drejtë të bëjë kallëzim penal kundër gazetarëve për shpifje, fyerje ose ndërhyrje në jetën e tyre private. Kodi Civil ka dispozita edhe për dëme jo-pasurore. Pas vendimit të formës së presë të gjykatës, paditësi mund të kërkojë kompensim financiar për fyerje ose publikim të qëllimshëm të informacionit shpifës. Pjesa më e madhe e padive bëhen nga politikanë, biznesmenë dhe përfaqësues të institucioneve publike. Nga analiza e vendimeve gjyqësore të viteve të mëparshme evidentohet se gjërat shumë të rënda dhe të kombinuara me kostot financiare për gazetarët, zvarritjet e procedurave, gjasat për të bërë padi penale, etj., mund të çojnë në autocensurë. Kjo situatë përbën kërcënim për lirinë e shprehjes, veçanërisht në rastet e gazetarëve profesionistë investigativë dhe kritikë.

Në Shqipëri, legjislacioni në fuqi përcakton se gazetarët mbajnë përgjegjësi për shpifje, e cila ende konsiderohet si kundërvajtje penale në kundërshtim me standardet e pranuar ndërkombëtarisht dhe rekomandimet e përsëritura nga Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian. Seksioni VIII "Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit" për veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit sipas Kodit Penal e përkufizon shpifjen si "Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit" (Neni 120). Gjërat për shpifje variojnë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë, madje edhe më të larta në varësi të rrethanave të veçanta të rastit, të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni. Po në këtë seksion përcaktohet se "Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një

herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë." Dënimi me burgim deri në dy vjet për shpifje është hequr që nga viti 2012. Në Kodin Penal përfshihet edhe nocioni i fyerjes, i cili parashikohet në Nenin 119: "Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë. Për më tepër, po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë." Ashtu si edhe më sipër, që nga viti 2012 është hequr dënimi me burgim deri në dy vjet për shpifje.

Neni 121 i Kodit Penal parashikon një tjetër kundërvajtje penale që mund të çojë në përgjegjësi penale ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias, me titull "Ndërhyrje të padrejta në jetën private". Sipas kësaj dispozite, "Vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, dëgjimi, regjistrimi ose transmetimi i fjalëve, fiksimi, regjistrimi ose transmetimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim apo publikimi i këtyre të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit pa pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale. Këto vepra dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Me këtë dispozitë, preket veçanërisht media investigative kur raporton për çështje me interes publik, pavarësisht se kjo bëhet duke ekspozuar, pa pëlqim, pjesë të jetës private të një personi.

Neni 119 i Kodit Penal përcakton se: "Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë. Për më tepër, po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë."

Po ashtu, Kodi Civil i Shqipërisë ka edhe dispozita që lidhen me shpifjen: Neni 617 për publikimet mashtruese ose të pasakta; Neni 625 Përgjegjësia për dëmin jopasuror dhe Neni 647/a që përcakton mënyrat dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe masës së dëmit jopasuror.

Kodi Penal nuk përcakton shprehimisht dëme më të rënda për gazetarët në krahasim me zyrtarët e shtetit. Pasojat për shpifjen, fyerjen e qëllimshme ose publikimet mashtruese ose të pasakta në lidhje me dëmet jopasurore përcaktohen rast pas rasti, duke marrë parasysh veçantitë dhe kontekstin e çdo rasti të paraqitur në gjykatën kompetente.

Duke pasur parasysh natyrën e punës së gazetarëve, kushtet në të cilat punojnë ata, niveli i ulët i pagave për shumicën e tyre dhe ndonjëherë edhe mjedisi informal i punës si dhe kufizimet në lirinë e gazetarisë kur një lajm imponohet nga redaktori apo pronari i medias, dënimet penale mund të konsiderohen si tepër të rënda. Përsa i përket përgjegjësisë civile, legjislacioni parashikon që dëmshpërblimi i dëmit jopasuror në lidhje me dëmtimin e nderit, personalitetit ose reputacionit të një personi synon rivendosjen e së drejtës së

dëmtuar, në përpjesëtim me dëmin e shkaktuar dhe caktohen në bazë të rrethanave të rastit. Kështu, gjyqtarët kanë diskrecionin të përcaktojnë ndëshkimet apo dëmshpërblimet.

Për shembull, Kodi Civil parashikon që për përcaktimin e përgjegjësisë civile dhe masës së dëmit jopasuror, gjykata merr parasysh faktorë të tjerë. Ndër këta faktorë që merren parasysh janë mënyra, forma dhe koha e aktit, shkalla e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënies, çështjet që lidhen me jetën private, interesi publik, fakti nëse autori i thënies të rreme ka përfituar nga shpërndarja e tyre, fakti nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të të pandehurit etj. (Neni 647/a).

Në Vendimin Unifikues Nr. 10, datë 14.09.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë thuhej se "Shuma e dëmshpërblimit për dëmin moral, për shkak të natyrës subjektive dhe të brendshme të tij, nuk mund të llogaritet mbi tabela dhe skema të parallogaritura vetëm për këtë qëllim. Prandaj, gjykata e cakton atë mbështetur në parimin e dhënies së drejtësisë sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre. Në këtë proces merren parasysh kriteret eventuale normative të zbatueshme sipas natyrës së të drejtës së cenuar ose, në mungesë të tyre, në kriteret dhe elemente vlerësimi të konsoliduar nga praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve analoge ose në përvoja përkatëse jashtëgjyqësore. Gjykata duhet të marrë parasysh edhe zhvillimin aktual ekonomik e social të vendit, përfshirë vlerën e parasë në ekonominë kombëtare."

Në vitin 2022, në Shqipëri u regjistruan gjithsej 30 çështje gjyqësore, që kishin të bënin me Nenin 119 (Fyerja) ose Nenin 120 (Shpifja) të Kodit Penal, të ngritura kundër gazetarëve ose punonjësve të medias. Prej tyre, 11 raste janë të bartura nga vitet e kaluara dhe 19 janë raste të reja. Po ashtu, në të njëjtin vit janë bërë 12 paditë civile, ku 11 prej tyre lidhen me Nenin 617 të Kodit Civil që parashikon publikime mashtruese ose të pasakta dhe një në lidhje me Nenin 625 të Kodit Civil që parashikon përgjegjësinë për dëmin jopasuror. Raporti i Qendrës A.L.T.R.I për vitin 2022 për paditë penale dhe civile kundër gazetarëve dhe përfaqësuesve të medias në Shqipëri tregon se gjobat variojnë nga rreth pesëdhjetë mijë lekë deri në tre milionë lekë. Përveç detyrimit për të tërhequr deklaratat, për të përgënjeshtuar deklaratat shpifëse ose për të fshirë artikujt e lajmeve që kanë të bëjnë me paditësin, këto gjopa mund të konsiderohen të rënda, veçanërisht kur merret parasysh paga mesatare e gazetarëve në Shqipëri.

Të dhënat e disponueshme nuk ofrojnë një tregues të qartë nëse vendimet e gjykatës kundër gazetarëve në Shqipëri gjatë vitit 2022 ishin të motivuara politikisht. Gjithsesi, klima tejet e polarizuar politike në vend dhe fakti që sistemi gjyqësor vazhdon të jetë në një fazë tranzicioni reformimi, i cili pavarësisht progresit ka hasur

edhe në sfida, nuk përjashton mundësinë e ndikimit të paverifikuar të politikës në sistemin gjyqësor.

Ka pasur raste të vonimit të trajtimit të çështjes dhe probleme me transparencën në vendimet gjyqësore, gjë që mund të bëjë të lindin dyshime për ndikimin e mundshëm të politikës.

Nuk ka asnjë provë përcaktuese që të sugjerojë se gjyqtarët, prokurorët apo zyrtarët e tjerë shtetërorë të kenë keqpërdorur postin e tyre gjatë proceseve gjyqësore kundër gazetarëve. Megjithatë, disa raste të konfirmuara të kërcënimit të gazetarëve gjatë procedurave gjyqësore kanë çuar në tërheqje dhe autocensurë.

Stërzgjatja dhe vonimi i proceseve gjyqësore, që shpesh shkojnë mbi dy apo tre vjet, dhe rritja eventuale e kostove financiare për gazetarët kanë ndikuar në mënyrë të tërthortë në kulturën e autocensurës në komunitetin e gazetarëve. Kjo nxitet edhe nga rastet e kërcënimit me të cilat përballen gazetarët gjatë procedurave. Edhe pse zyrtarët shtetërorë mund të mos keqpërdorin drejtpërsëdrejti të drejtat e tyre procedurale, atmosfera që pason shpesh mund të shtypë lirinë e gazetarisë dhe të nxisë autocensurën.

Procedurat e stërzgjatura gjyqësore, kostot financiare që lidhen me proceset gjyqësore dhe gjasat e një dënimi penal kanë pasur efekt negativ në lirinë e gazetarëve, duke bërë që shumë nga këta të fundit të vetëcensurohen. Në mënyrë të veçantë, mes gazetarëve dhe ekspertëve të pavarur të mediave, gazetarëve investigativë dhe atyre kritikë ka një ndjesi në rritje se proceset gjyqësore të shpifjes po ndikojnë negativisht te gazetaria e pavarur profesionale dhe cilësore në Shqipëri. Kjo tendencë përkeqësohet edhe më shumë nga fakti se në përgjithësi gazetarët në paditë gjyqësore ndaj tyre nuk kanë mbështetje institucionale nga organizatat e mediave apo nga punëdhënësit e tyre. Kjo mungesë mbështetjeje krijon një efekt frenues, ku gazetarët detyrohen të heqin dorë nga raportimi kritik për shkak të frikës prej pasojave ligjore dhe financiare.

Pasojat e vendimeve të mëparshme vazhdojnë të ushtrojnë ndikim negativ te gazetarët. Shumat e gjobave nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë në vendimet e mëparshme gjyqësore janë mjaft të larta po të kemi parasysh pagën mesatare të gazetarëve në Shqipëri. Së fundmi, vihet re një tjetër fenomen shqetësues, që lidhet me rritjen e numrit të padive për shpifje të ngritura nga gazetarët kundër kolegëve të tyre duke përkeqësuar kështu edhe më tej sfidat që hasen në këtë profesion.

Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve garantohet me ligj dhe respektohet nga autoritetet

Pikët për 2021: 3,86 / Pikët për 2022: 4,14

Kuadri ligjor i Shqipërisë, konkretisht neni 159 i Kodit të Procedurës Penale, mbështet parimisht të drejtën për të ruajtur konfidencialitetin e burimit, duke e njohur atë si një nga kushtet themelore të lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes. Kjo mbrojtje merr formën e një sekreti profesional, duke përjashtuar kështu gazetarët nga detyrimi për të zbuluar burimet e tyre të informacionit. Pavarësisht kësaj, legjislacioni në fjalë parashikon përjashtime, ku gjykatës i jepet e drejta të urdhërojë në rrethana të caktuara zbulimin e burimit të informacionit. Në vitin 2022 nuk u regjistruan raste të tilla. Po ashtu, në këtë vit nuk pati asnjë ndryshim të dispozitave ligjore që mbrojnë burimet e gazetarëve si dhe nuk u regjistrua asnjë rast ku autoritetet shtetërore të detyronin gazetarët të dorëzonin pajisje elektronike që mund të rrezikonte potencialisht identitetin e burimit. Ky është një përmirësim i dukshëm në krahasim me vitin 2021, ku në një rast të profilit të lartë u bë sekuestrimi i pajisjeve elektronike të një medie. Megjithatë, në vitin 2022 gazetarët, veçanërisht ata investigativë, u përballën sërish me sfida që lidhen krijimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve me burimet e tyre. Shqetësimet në përgjithësi për sigurinë dhe kushtet e paqëndrueshme të punës vazhduan t'i vështirësojnë këto përpjekje, duke sjellë kështu pengesa për lirinë dhe aftësinë e gazetarëve për të ruajtur kontakte me burimet e rëndësishme të informacionit.

Kuadri ligjor në Shqipëri garanton të drejtën e mbrojtjes së burimeve konfidenciale të gazetarit si një nga parimet bazë të lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes. Siç përcaktohet edhe në Nenin 159 të Kodit të Procedurës Penale, gazetarët përjashtohen nga detyrimi për të bërë të ditur burimin e informacionit, duke e konsideruar atë sekret profesional. Mirëpo, gjykata mund ta urdhërojë gazetarin të tregojë burimin e informacionit të tij/saj nëse një gjë e tillë është me rëndësi të madhe për të vërtetuar veprën penale. Edhe standardet etike e detyrojnë gazetarin të mos e zbulojë burimin e informacionit. Ndonëse ligjin e ruan këtë parim, në praktikë kjo gjë mund të komprometohet nga vendimi i gjykatës penale

që kërkon zbulimin e burimit. Pavarësisht skenarëve të tillë, gazetarët kanë detyrimin etik të mos e zbulojnë burimin e informacionit, duke penguar kështu pëlqimin e dhënë shprehimisht nga pala në fjalë për zbulimin e burimit.

Për vitin 2022 nuk ka pasur asnjë rast të regjistruar në Shqipëri ku gazetarëve t'u kërkohej të zbulonin burimin e informacionit qoftë për arsye të interesit publik apo edhe për zgjidhjen e ndonjë çështjeje të caktuar penale. Gjatë këtij viti, nuk ka pasur ndryshime në dispozitat ligjore për ruajtjen e konfidencialitetit të burimeve të gazetarëve në Shqipëri. Po ashtu, në këtë vit nuk ka pasur raste të regjistruara ku gazetarët të jenë ndëshkuar për shkak të refuzimit për të treguar burimin e informacionit. Gjithsesi, Aleksandra Bogdani, gazetare investigative për Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Investigative (BIRN) në Shqipëri, u thirr për të dhënë dëshmi përpara Komisionit Parlamentar që hetonte rastet e diskutueshme të inceneratorëve. Dëshmia e saj në lidhje me raportimin e saj gazetaresk për këto raste ishte e detyrueshme sipas rregullave të këtij komisioni parlamentar. Gjatë këtyre procedurave, deputetët mund ta pyesnin për burimet e saj për hir të hetimit të këtij komisioni. Zonjës Bogdani nuk iu bënë presione të drejtpërdrejta për të zbuluar burimet e saj.

Në vitin 2022, në Shqipëri nuk u raportua asnjë incident i tillë ku autoritetet shtetërore të kenë urdhëruar gazetarët që të dorëzonin pajisjet elektronike, për të rrezikuar kështu zbulimin e burimeve të tyre. Kjo situatë është në kontrast me vitin e kaluar, 2021, ku ndodhi një rast i rëndë dhe ku përfshiheshin prokurorë specialë të antikorrupsionit dhe krimi të organizuar, të cilët kërkuan konfiskimin e kompjuterëve, serverëve, telefonave dhe disqeve USB të portalit të një medie online. Ky rast ngjalli reagime të shumta, përfshirë edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), reagimi i së cilës bëri që Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) në Shqipëri të rishikonte dhe ndryshonte urdhrin e saj.

Në vitin 2022, gazetarët në Shqipëri, veçanërisht ata që merren me gazetari investigative dhe që raportojnë mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin, vazhduan të përballen me pengesa në marrjen e informacionit dhe në ruajtjen e kontakteve me burimet e informacionit. Kjo situatë nuk ka ndryshime nga periudhat e mëparshme të raportimit për sa i përket vështirësive me të cilat përballen ata. Këto sfida vështirësohen edhe më tej nga problemet e sigurisë dhe kushtet e pasigurta të punës të këtyre gazetarëve, duke ndikuar kështu në lirinë dhe besimin e tyre për krijimin dhe ruajtjen e kontakteve me burimet e rëndësishme të informacionit.

Ligjet e tjera zbatohen me objektivitet dhe u bëjnë të mundur gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias të punojnë lirisht dhe të sigurt

Pikët për 2021: 3,22 / Pikët për 2022: 3,11

Në Shqipëri, zbatimi i ligjeve të tjera të rëndësishme që lidhen me gazetarët dhe aktorët e medias ka sjellë vështirësi për lirinë dhe sigurinë e tyre. Ligjet që lidhen me shpifjen, gjuhën e urrejtjes, të drejtën e autorit, privatësinë e personit dhe mbrojtjen e të dhënave janë zbatuar në mënyrë selektive, duke kufizuar potencialisht punën e gazetarëve. Në vitin 2022, ka pasur raste kur dispozitat ligjore u imponuan padrejtësisht për të kufizuar përhapjen e informacionit të rrjedhur pas një sulmi kibernetik. Nga ana tjetër, praktikët e zyrtarëve publikë ku japin përmbajtje të përgatitur paraprakisht që zëvendëson angazhimin e drejtpërdrejtë me gazetarët, kanë ngritur shqetësime për lirinë e medias, marrjen e informacionit dhe transparencën. Ndonëse në vitin 2022 nuk ka pasur raportime për raste të padive të shumta që synojnë pengimin e hetimeve për korrupsion dhe veprimtari të paligjshme, gazetarët ende përballen me kërcënime dhe kushte të vështira pune. Për më tepër, gazetarët që mbulojnë protestat janë përballur me ndalime të shkurtra të padrejta nga policia dhe janë bërë pre e dhunës dhe ngacmimeve, gjë që ka rrezikuar aftësinë e tyre për të punuar në liri dhe me siguri.

Në Shqipëri ekzistojnë mundësitë për zbatimin arbitrar të ligjeve duke dëmtuar kështu lirinë e shprehjes së gazetarëve. Ligjet që trajtojnë çështjet si shpifjen, gjuhën e urrejtjes, fyerjet, të drejtat e autorit, jetën private dhe mbrojtjen e të dhënave shpesh janë përdorur si arsye për kufizimin e punës së gazetarëve.

Në vitin 2020 ka pasur raste të kufizimit të përmbajtjes online apo akuza ndaj gazetarëve dhe qytetarëve për përhapje paniku dhe frike gjatë ngjarjeve të tilla si pandemia Covid-19 dhe tërmeti. Kjo tendencë vazhdoi edhe në vitin 2021, ku gazetarëve me raste iu refuzohej aksesit për raportim duke përdorur masat anti-Covid-19 si arsye. Në vitin 2022, pas një sulmi të rëndë kibernetik në sistemin e qeverisjes elektronike të Shqipërisë,

autoritetet i penguan organet e medias të botonin rrjedhjen e informacionit duke cituar si arsye rrezikun e panikut publik.

Pavarësisht nisjes së dhënies së deklaratave javore për shtyp në shtator të 2021, Kryeministri dhe ministrat dhanë një numër të kufizuar konferencash për shtyp ku mundësohej ndërveprimi i vërtetë me gazetarët. Në vitin 2022 shumica e këtyre seancave u shndërruan në deklarata për shtyp, duke përjashtuar kryesisht gazetarët. Për më tepër, ka pasur dy raste në vitin 2022 ku kryeministri Rama qortonte gazetarët për pyetjet kritike që bënin ata, duke i dërguar për "riedukim". Këto zhvillime nënvizojnë një nevojë urgjente për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe respektimit për lirinë e medias në Shqipëri.

Janë shfaqur tendenca shqetësuese që kanë dalë nga praktikat e gabuara dhe të dëmshme të zyrtarëve publikë në Shqipëri, praktika si ofrimi i përmbajtjes së parapërgatitur për transmetim nga mediat. Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe përfaqësues të tjerë të lartë të qeverisë vazhduan t'i bëjnë bisht konferencave për shtyp, duke kufizuar aksesin e gazetarëve në ngjarjet publike por duke iu dhënë atyre materiale të parapërgatitura. Kjo metodë pengon jashtëzakonisht shumë pyetjet kritike dhe raportimin gjithëpërfshirës, duke ngritur shqetësime për lirinë e medias, aksesin në informacion dhe transparencën.

Në vitin 2022, u bënë përpjekje për të kufizuar punën e gazetarëve në Shqipëri duke përdorur dispozitat ligjore që lidhen me shpërndarjen e informacioneve të rreme apo përhapjen e panikut. Një rast serioz ndodhi më 19 shtator 2022, kur Prokuroria e Tiranës ndaloi mediat dhe publikun e gjerë të publikonin çdo të dhënë apo informacion të marrë nga sulmet kibernetike ndaj serverëve të shtetit shqiptar që nisën në korrik 2022. Këto sulme kibernetike Microsoft ia atribuoi më vonë grupeve të hakerave iraniane, sulme që sollën si rezultat dëme të konsiderueshme të bazës së të dhënave të qeverisë dhe sistemeve kompjuterike të institucioneve publike. Një grup i quajtur "Drejtësia e Atdheut (Homeland Justice)", që dyshohet se ishte i lidhur me hakerat iraniane, publikoi dokumente që përmbanin të dhëna të klasifikuara të policisë dhe korrespondencë konfidenciale që përfshinte politikanë, autoritete, institucione shqiptare dhe diplomatë të huaj.

Në përgjigje të rrjedhjeve, qeveria shqiptare akuzoi Iranin për orkestrimin e sulmeve, duke çuar në ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike mes dy shteteve. Mediat shqiptare më pas publikuan artikuj në lidhje me përmbajtjen e rrjedhur, me fokus komplotet e dyshuara për atentat dhe çështje që lidhen me Policinë e Shtetit.

Ndalimi nga Prokuroria e Tiranës i publikimit të të dhënave justifikohet me sigurinë kombëtare dhe privatësinë. Në deklaratën e Prokurorisë paralajmërohej se kushdo që kapej duke publikuar të dhënat do t'i bëhej kallëzim penal sipas Nenit 293/b "Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike" dhe Nenit 192/b "Hyrja e paautorizuar në kompjuter" të Kodit Penal. Vlen të

theksohet se asnjë nga dispozitat e Kodi Penal të përmendur në urdhrin e prokurorisë nuk sjell përgjegjësi penale për gazetarët nëse ata publikojnë të dhëna ose informacione të marra nga sulmet kibernetike ndaj serverëve të shtetit shqiptar të nisura në korrik të vitit 2022. Përgjegjësia penale është vetëm e atyre që hyjnë në sistemet kompjuterike, deformojnë ose shtrembërojnë informacionin, etj. Për më tepër, në deklaratë thuhej se çdo faqe interneti që publikonte të dhënat do të bllokohej. Prokuroria ngarkoi një njësi hetimi të krimit kibernetik të Policisë së Shtetit për të monitoruar shkeljet dhe kërkoi informacione nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). Më 20 shtator, AMA evidentoi natyrën e ndjeshme dhe konfidenciale të dokumenteve të hakuara dhe u bëri thirrje redaksive të tregojnë kujdes dhe përgjegjësi profesionale në trajtimin e të dhënave.

Në Shqipëri kuadri ligjor në fuqi fatkeqësisht nuk u ofron mbrojtje të posaçme gazetarëve që paditen përmes padive SLAPP. Ndihma ligjore e garantuar nga shteti përmes Ligji Nr. 111/2017 është i vetmi legjislacion që parashikon mundësinë e përjashtimit nga tarifat gjyqësore dhe përfitimin e ndihmës juridike falas. Gjithsesi, kategoritë e përfituesve sipas këtij ligji nuk përfshijnë gazetarët dhe janë vetëm për kategori të caktuara, si persona me aftësi të kufizuara, viktimat e abuzimit seksual, trafikimit, etj. Kështu, nëse gazetarët paditen në gjykatë me padi SLAPP, ata duhet të marrin një avokat për të pasur një mbrojtje juridike profesionale.

Një rast i njohur ishte gazetari Isa Myzyraj nga Ora News, i cili u kërcënua për raportimin mbi procesin e vetingut të Elizabeta Imerajt, ish-drejtuese e Prokurorisë së Tiranës. Imeraj ngriti padi për shpifje kundër Myzyrajt, duke e përfshirë atë në një luftë të stërzgjatur ligjore. Raste të tjera janë paditë për shpifje ndaj dy gazetarëve të tjerë në Shqipëri nga kompani të lidhura me çështjen e nxehtë të inceneratorëve.

Paditë SLAPP përbëjnë kërcënim për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias në Shqipëri, duke dëmtuar aftësinë për të raportuar për çështje me interes publik, veçanërisht për korrupsionin e nivelit të lartë dhe krimin e organizuar, siç janë tre rastet e raportuara në 2020 nga gazetarë të BIRN-it dhe gazetarë të tjerë të pavarur. Megjithatë, si zhvillim pozitiv, në vitin 2021 dhe 2022, nuk u raportuan raste të padive të tilla të iniciuara kundër gazetarëve nga individë apo grupe të fuqishme për shpifje të supozuar me qëllim pengimin e investigimeve dhe të raportimit mbi praktika korruptive ose të paligjshme.

Gjithsesi, është e rëndësishme të theksohet se gazetarët dhe ekspertët e medias kanë konfirmuar se gazetarët investigativë dhe ata kritikë përballen me kërcënime dhe kushte të vështira pune, të cilat në mënyrë të pashmangshme ndikojnë në raportimin e tyre të pavarur. Nga ana tjetër, numri i lartë i rasteve të pushuara sugjeron se padive civile dhe penale kundër gazetarëve shpesh u mungon baza ligjore ose qëllimi i mbështetur në ligj.

Të drejtat dhe siguria e gazetarëve në Shqipëri kanë qenë herë pas here në rrezik, veçanërisht gjatë pasqyrimin të protestave qytetare. Historikisht, incidente të tilla kanë çuar në shoqërimin ose ndalimin e paligjshëm (heqje e lirisë për një kohë të shkurtër) të gazetarëve ose tentativa për të konfiskuar pajisjet e tyre nga punonjës të policisë. Kjo situatë u bë më e dukshme veçanërisht në vitin 2020, gjatë protestave që nisën me shembjen e Teatrit Kombëtar dhe gjatë një incidenti të diskutueshëm me policinë.

Në vitin 2021, edhe pse pati një rënie të rasteve të tilla, kishte raste sporadike të komprometimit të sigurisë së gazetarëve gjatë raportimit drejtpërsëdrejti nga vendngjarjet, përfshirë këtu edhe sulme nga individë privatë.

Fatkeqësisht, incidente të tilla pati edhe në vitin 2022, ku gazetarët u përballën me forma të ndryshme dhune dhe ngacmimi. Pati raste ku efektivë të policisë tentuan të pengonin raportimin live nga protestat si dhe ku janë bërë sulme të drejtpërdrejta fizike ndaj gazetarëve. Veprime të tilla dëmtojnë aftësinë e gazetarëve për të raportuar të lirë të dhe të sigurt nga vendngjarjet, veçanërisht nga protestat qytetare për çështje të tilla si rritja e çmimeve të ushqimeve, karburantit dhe energjisë apo kundër projekteve të rizhvillimit urban.

Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të krijojnë, të anëtarësohen e të marrin pjesë në shoqatat e tyre

Pikët për 2021: 3,76 / Pikët për 2022: 3,73

Në vitin 2022, gazetarëve në Shqipëri nuk u kërkohej licencë për të ushtruar profesionin dhe nuk pati zhvillime të rëndësishme në lidhje me krijimin e një statusi zyrtar për ta. Pati shqetësime në lidhje me akreditimin e mediave nga një institucion i ri i sistemit gjyqësor dhe konsultimet nuk sollën ndryshime të mëdha në rregulloren problematike të këtij institucioni. Gazetarët dhe reporterët e pavarur hasin vështirësi për njohjen e tyre si gazetarë, pasi nga praktikatat e deritanishme shpesh lejohen vetëm ata që përfaqësojnë një media tradicionale. Gazetarët në Shqipëri janë të lirë të organizohen dhe të anëtarësohen në shoqata profesionale, pa pengesa të raportuara për vitin 2022. Gjithsesi, në Shqipëri konsolidimi i këtyre shoqatave është ende proces në vazhdim. Nuk pati raste të organizatave mediatike paralele apo të rreme synimi i të cilave është të minojnë shoqatat e vërteta të gazetarëve.

Në Shqipëri gazetarët nuk kanë nevojë të kenë licencë shtetërore apo licencë tjetër për të punuar në gazetari. Megjithatë, në vitin 2021, një grup gazetarësh krijuan Lëvizjen e Gazetarëve për të lobuar për krijimin e statusit të gazetarëve. Ndonëse ekspertë të medias shprehën shqetësime se kjo mund të jetë praktikisht kriter për licencim, nuk ka pasur zhvillime të konsiderueshme në këtë drejtim gjatë vitit 2022. Kësisoj, në vitin 2022 gazetarët në Shqipëri kanë lirinë të ushtrojnë profesionin e tyre pa pasur nevojë për licencë të dhënë nga shteti. Është me rëndësi të theksohet se mungesa e kriterëve të licencimit bën të mundur më shumë liri dhe akses në fushën e gazetarisë, duke u mundësuar kështu gazetarëve të drejtën e lirisë së shprehjes dhe pjesëmarrjes në shoqata profesionale.

Në vitin 2022 pati shqetësime lidhur me akreditimin e mediave dhe ndikimin e këtij akreditimi në lirinë e tyre në Shqipëri. Prezantimi i një rregulloreje të re për marrëdhëniet me median nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) vuri në pikëpyetje transparencën, aksesin në informacion dhe lirinë e medias. Rregullorja thotë në Nenin 8 (paragrafi 3) se Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, me miratimin e anëtarit përkatës të Këshillit, ka të drejtë të kërkojë nga drejtuesi përkatës i medias,

zëvendësimin e një gazetari të akredituar, nëse ka shkelje të qarta të objektivitetit dhe profesionalizmit, Kushtetutës, ligjit dhe parimeve të kësaj rregulloreje. Sipas pikës 4 të të njëjtit nen, në rastin kur shkelja është publike, e rëndë ose flagrante, anëtari përkatës i Këshillit merr vendim për heqjen e akreditimit të gazetarit që ka kryer shkeljen. Megjithatë, kriteret dhe procesi për vlerësimin e profesionalizmit të gazetarëve dhe transparencës së raportimit mbetën të paqarta. Nga ana tjetër, roli i Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në KLP dhe anëtarit të Këshillit përkatës përgjegjës për mediat nuk është përcaktuar qartë. Fillimisht, rregullorja u shpall pa u konsultuar me aktorët përkatës, por pasi u përball me kritikën publike, KLP u angazhua në konsultime me gazetarët. Gjithsesi, rregullorja nuk është rishikuar, por ajo nuk është zbatuar në mënyrë rigoroze nga KLP. Këto zhvillime nxjerrin në pah nevojën për procese të qarta dhe transparente akreditimi për mbrojtjen e lirisë së medias dhe garantimin e përhapjes pa pengesa të informacionit.

Në Shqipëri, të gjitha institucionet kanë në përgjithësi procedura për akreditimin e gazetarëve dhe disa institucione të reja të sistemit të drejtësisë janë në procesin e hartimit të politikave të akreditimit. Një praktikë e zakonshme për të gjitha autoritetet publike është kërkesa që gazetarët të mbajnë një distinktiv lehtësisht të identifikueshëm. Gjithsesi, sfida mbetet njohja e gazetarëve të lirë, blogerëve dhe gazetarëve të pavarur që nuk punojnë për organizata apo subjekte mediatike.

Ky problem përbën shqetësim për trajtimin dhe njohjen e barabartë të të gjithë gazetarëve, pavarësisht statusit të punësimit apo përkatësisë e tyre. Është e rëndësishme që autoritetet të sigurojnë që proceset dhe politikat e akreditimit të përshtatin peizazhin e ndryshëm të gazetarisë, përfshirë gazetarët e pavarur dhe ata që punojnë në formate jotradicionale. Njohja dhe respektimi i të drejtave dhe privilegjeve profesionale të të gjithë gazetarëve, pavarësisht formatit dhe vendit të punës, është me rëndësi të jashtëzakonshme për mbrojtjen e lirisë së medias dhe garantimin e ushtrimit me efikasitet të rolit të tyre të rëndësishëm në shoqëri.

Në Shqipëri, gazetarët janë përgjithësisht të lirë të organizohen në shoqata profesionale dhe kanë të drejtën të anëtarësohen në shoqata ekzistuese. Ky parim u bën të mundur gazetarëve të bashkohen, të ndajnë interesa të përbashkëta dhe të mbrojnë bashkërisht të drejtat profesionale dhe interesat e tyre.

Gjatë vitit 2022, nuk u raportua asnjë rast ku gazetarët të kenë hasur në pengesa apo kufizime për t'u bërë anëtarë të shoqatave. Kjo nënkupton se gazetarët në Shqipëri kanë mundësinë të ushtrojnë të drejtën e pjesëmarrjes dhe anëtarësimit në organizata profesionale pa ndërhyrje apo kufizime të padrejta.

Aftësia e gazetarëve për t'u anëtarësuar në shoqata është e rëndësishme, pasi nxit solidaritetin, mbështet zhvillimin profesional dhe forcon zërin kolektiv të gazetarëve në mbrojtjen e lirisë së shtypit, për etikën e medias dhe mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve. Si anëtarë të shoqatave, gazetarët mund të kenë akses në burime, mundësi trajnimi, mbështetje ligjore dhe platforma rrjetëzimi që kontribuojnë në rritjen dhe mirëqenien e tyre profesionale. Për më tepër, shoqatat luajnë një rol jetik në promovimin e standardeve profesionale, etikën e sjelljes së gazetarit dhe garantimin e pavarësisë dhe integritetit të gazetarisë. Megjithatë, në Shqipëri këto struktura nuk janë të konsoliduara ende.

Gjatë vitit 2022 në Shqipëri nuk janë raportuar raste të organizatave mediatike paralele apo të rreme, të mbështetura nga qeveria qendrore apo organizata të fuqishme politike, synimi i të cilave është të minojnë qëndrimin kritik të shoqatave të vërteta të gazetarëve. Edhe pse është e rëndësishme të rritet vigjilenca dhe të vëzhgohet peizazhi i mediave për ndonjë zhvillim të tillë, nuk ka informacione apo evidenca specifike që të sugjerojë ekzistencën e organizatave të tilla në vend.

Gjithsesi, vlen të theksohet se përqendrimi i pronësisë së medias në disa duar dhe ndikimi i politikës në to kanë qenë tema shqetësuese për peizazhin e mediave në vend. Mediat me lidhje me partitë politike ose individë të fuqishëm mund të imponojnë mënyrën e përçimit të informacionit dhe të ndikojnë në debatin publik. Kjo situatë thekson rëndësinë e promovimit të pluralizmit të mediave, transparencës në pronësinë e tyre dhe sigurimit të një mjedisi ku gazetarët dhe organizatat e mediave të mund të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje të panevojshme.

Përpyjekjet për forcimin e sektorit të medias, mbështetjen e gazetarisë së pavarur dhe promovimin e standardeve etike janë me rëndësi të madhe për ruajtjen e një peizazhi të larmishëm dhe aktiv të mediave ku sigurohet mbështetje për parimet e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias. Është po aq e rëndësishme të nxitet një mjedis ku shoqatat e vërteta të gazetarisë të mund të lulëzojnë, të mbështesin standardet profesionale dhe të shërbejnë si një zë i fortë për komunitetin e gazetarëve.

Vendi i punës i gazetarëve është i garantuar dhe i mbrojtur në mjedisin e punës

Pikët për 2021: 2,51 / Pikët për 2022: 2,27

Në vitin 2022, gazetarët në Shqipëri u përballën me vështirësi të vazhdueshme për sa i përket të drejtave dhe kushteve të punës. Pavarësisht faktit se pjesa më e madhe e tyre kanë kontrata formale pune, ka pasur një përkeqësim të dukshëm të kushteve të punës, veçanërisht në lidhje me vonesat e pagave dhe pushimet e paligjshme nga puna. Gazetarët, veçanërisht ata që punojnë në mediat online, i përjetuan më keq këto problematika. Frika nga reprezaljet dhe solidariteti i pronarëve të mediave u bënë pengesë që gazetarët t'i trajtojnë këto probleme publikisht ose përmes kanaleve institucionale. Kërcënimet ndaj sigurisë dixhitale si hakerimi dhe survejimi i rrezikuan më tej gazetarët, duke theksuar nevojën për përmirësimin e masave të sigurisë kibernetike. Shqetësime të mëdha janë edhe diskriminimi gjinor dhe vështirësitë e lidhura me të, veçanërisht për gratë gazetare.

Në Shqipëri, gazetarët në shumicën e rasteve punojnë me kontrata të rregullta pune. Megjithatë, të drejtat e punës të gazetarëve ende përballen me sfida për sa i përket zbatimit. Disa nga këto sfida janë vonesat dhe informaliteti i pagesave, parregullsia në pagimin e sigurimeve shoqërore, oraret e gjata të punës, numri i kufizuar i ditëve pushim dhe problemet e largimit të paligjshëm nga puna. Disa gazetarë (si korrespondentët e rretheve apo gazetarët e portaleve) janë marrë në punë me kontrata konsulence ose shërbimi, të cilat nuk rregullohen nga Kodi i Punës, pra si ekspertë të jashtëm. Një situatë e tillë bën që mbrojtja ligjore e garantuar për këtë kategori të jetë në nivele minimale, duke krijuar një mjedis të pafavorshëm për kushtet e punës. Në një raport të vitit 2022 theksohet se gazetarët e reja që punojnë në mediat online janë veçanërisht objekt i mungesës së kontratave të punës, ndërkohë që rregullsia e pagesave është një shqetësim për gazetatat, mediat online dhe mediat lokale. Kjo do të thotë se nuk mjaftojnë vetëm kontratat e rregullta për të siguruar zbatimin e plotë të të drejtave në punë. Nevojitet të ndërmerren reforma për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave në punë dhe respektimin e rregulloreve ekzistuese, duke përmirësuar kështu kushtet e punës së gazetarëve në Shqipëri.

Për më tepër, kanë dalë në pah pabarazi të theksuara në pagat e gazetarëve, duke evidentuar një hendek të madh të

rrogave mes punonjësve të medias. Ndërkohë që disa individë, si prezantues, producentë dhe gazetarë të caktuar, marrin paga të larta deri në 20,000 euro në muaj, të tjerët paguhen shumë herë më pak. Nga rrjedhja e të dhënave nënvizohet prania e praktikave informale në industrinë e medias. Gazetarët paguhen mesatarisht me rreth 500 euro në muaj, që është dyfishi i pagës minimale. Kjo mospërputhje e pagave jo vetëm që përjetëson pabarazinë e të ardhurave, por përbën rrezik edhe për pavarësinë dhe integritetin e gazetarisë, pasi presionet financiare dhe praktikat joformale mund të ndikojnë në cilësinë e raportimit. Garantimi i transparencës dhe drejtësisë në praktikat e pagave është me rëndësi të madhe për nxitjen e një gazetarie më të barabartë dhe profesionale në Shqipëri.

Në vitin 2022, nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt u dokumentuan një sërë rastesh të shkeljes së të drejtave të gazetarëve në Shqipëri. Një incident i njohur kishte të bënte me denoncimet nga gazetarët dhe punonjësit e medias të RTSH-së, të cilët pretendonin se ishin shkarkuar si pjesë e një ristrukturimi pas emërimit të Drejtorit të ri të Përgjithshëm. Edhe pse ky i fundit ka kompetencat për të emëruar dhe shkarkuar drejtorët apo drejtuesit kryesorë sipas ligjit, këto veprime duhet të kryhen në mënyrë transparente dhe në përputhje me të drejtat në punë të gazetarëve. Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt kërkoi informacione për numrin e gazetarëve dhe stafit të medias në fjalë, por RTSH u përgjigj duke thënë se të gjitha procedurat janë ndjekur sipas Kodit të Punës dhe se asnjë gazetar nuk është pushuar nga puna. Pavarësisht raportimeve të shumta, asnjë punonjës i medias apo gazetar nuk ka dalë publikisht për të trajtuar këto çështje, me gjasa për shkak të frikës nga hakmarrja dhe mjedisit të vështirë mediatik ku pronarët e mediave mund të solidarizohen dhe të bëhen bashkë kundër ankesave të gazetarëve.

Në muajt e fundit të vitit 2022, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt mori denoncime edhe nga stafi i Euronews Albania, të cilët raportonin për shkarkimin e supozuar të rreth 30 punonjësve për shkak të ndryshimeve në drejtimin e medias. Shumica e personave në fjalë u detyruan të jepnin dorëheqjen, ndërsa një numër i vogël u pushuan pa paralajmërim. Jetmira Kaçi, ish-producente ekzekutive me kontratë të përhershme pune, e denoncoi publikisht shkarkimin e saj si të pajustificuar dhe nisi procedurat ligjore. Ajo është një nga të paktat punonjëse të medias që ka dalë publikisht, pasi ekzistenca e mundshme e presioneve informale dhe frika e hakmarrjes profesionale duket se i tremb të tjerët dhe bën që të mos dalin hapur me denoncimin e rasteve të ngjashme të shkarkimeve të paligjshme ose dorëheqjeve të detyruara. Është e rëndësishme të theksohet se Inspektorati i Punës nuk raportoi asnjë shkelje të Kodit të Punës tek Euronews Albania, duke e shtuar edhe më tej kompleksitetin e situatës për shkak të denoncimeve kontradiktore të gazetarëve me informacionet nga autoritetet publike.

Po ashtu, edhe FaxNews, Oranews dhe RTV Ora, janë disa media të tjera që u përballën me vështirësi të mëdha

gjatë këtij vitit. FaxNews pati vonesa të konsiderueshme në kalimin e pagave të gazetarëve dhe stafit të medias, të cilat i atribuoheshin vdekjes së pronarit dhe vështirësive të rënda financiare me të cilat përballej kjo medie. Po kështu, Oranews dhe RTV Ora kanë hasur në vonesa në kalimin e pagave të personelit, madje RTV Ora u sekuestrua nga shteti në zbatim të ligjit antimafia ndaj pronarit të saj.

Përveç këtyre sfidave, gazetarët në Shqipëri përballen me kërcënimin në rritje të sigurisë dixhitale, përfshirë këtu hakerimin, mashtrimin (phishing) dhe spiunimin (survejimin). Gazetarët që punojnë për mediat online janë veçanërisht të cenueshëm për shkak të përhapjes së praktikave të punësimit në të zezë. Mungesa e kontratave të rregullta mund të sjellë vështirësi për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe krijimin e profileve të tyre profesionale. Për më tepër, nga rrjedhja masive e të dhënave personale në 2021 dhe një sulm kibernetik në masë në 2022 u zbuluan të dhëna të tjera personale, përfshirë këtu llogaritë bankare, duke ngritur shqetësime për sigurinë dhe privatësinë e gazetarëve dhe të burimeve të tyre. Është me rëndësi të madhe që gazetarët t'i japin përparësi sigurisë dixhitale dhe organizatat e medias të zbatojnë masa të rrepta të sigurisë kibernetike për mbrojtjen e punonjësve të tyre dhe të të dhënave konfidenciale.

Gazetarët në Shqipëri përballen me vështirësi të mëdha dhe diskriminim gjinor në vendin e punës. Në vitin 2022, dolën në pah probleme me ngacmimin seksual, dhunën në internet dhe disinformimin me bazë gjinore. Megjithatë, denoncimet për raste të tilla janë mjaft të kufizuara, pasi gazetarët kanë frikë nga hakmarrja. Nevojitet më shumë mbështetje dhe mbrojtje më e madhe, përfshirë këtu përmirësimin e mekanizmave të denoncimit dhe masave për trajtimin e diskriminimit dhe ngacmimeve. Gratë janë të nënpërfaqësuar në redaksi dhe nivele vendimmarrëse, ndërkohë që mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë pengon monitorimin e progresit në këtë drejtim. Gratë gazetare përballen me pabarazi të madhe pagash për shkak të gjinisë, duke ndikuar negativisht në fuqizimin e tyre ekonomik dhe mundësitë për poste drejtuese dhe udhëheqëse. Ngacmimet seksuale, dhuna në internet dhe fushatat e shpifjeve janë forma të zakonshme të presionit me të cilat përballen gazetarët, me raste shpesh të paraportuara. Shqetësimet për disinformimin gjinor dhe ngacmimet online pengojnë edhe më shumë ecjen përpara në karrierë dhe pjesëmarrjen e tyre.

Gazetarët e pavarur në Shqipëri (ata që nuk janë të punësuar në një media të vetme) përballen me kushte më të pasigurta pune, pasi hasin në vështirësi për t'u njohur si gazetarë. Shpesh ndeshen me pasiguri për pagat dhe mospagim të sigurimeve shoqërore, gjë që përkeqëson edhe më shumë situatën e tyre tashmë të pasigurt.

Pavarësisht dispozitave të Kodit të Punës që u jep të drejtën një grupi prej të paktën 20 punonjësish të organizohen në sindikata për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre,


— TREGUES 1.5

gazetarët apo punonjësit e mediave në Shqipëri nuk janë të organizuar në sindikata. Gazetarët ia atribuojnë mungesën e sindikatave frikës nga veprimet hakmarrëse të pronarëve të mediave të tyre. Nga ana tjetër, gazetarëve nuk u sigurohet ndihmë juridike falas nga punëdhënësi dhe nuk kanë nënshkruar as marrëveshje kolektive për mbrojtjen e të drejtave të tyre në punë në mediat private. Kjo mungesë sindikatash dhe i marrëveshjeve kolektive i lë gazetarët pa mbrojtjen dhe mbështetjen e duhur në vendin e punës.



Parandalimi i duhur

2,95



29

Gazetarët dhe aktorët e medias kanë akses te masat e menjëhershme dhe efektive mbrojtëse kur ndjehen të kërcënuar

Pikët për 2021: 2,85 / Pikët për 2022: 2,80

Në vitin 2022, nuk pati asnjë ndryshim të rëndësishëm për sa i përket institucioneve përkatëse shtetërore në Shqipëri, për krijimin e mekanizmave efikase dhe të specializuara për individët, përfshirë edhe gazetarët, ku të raportohet gjuha e urrejtjes dhe kërcënimet serioze për jetën. Ekziston një numër urgjence pa pagesë (112). Sipas legjislacionit në fuqi, gazetarët dhe punonjësit e medias nuk kanë përfitojnë ndihmë juridike falas apo të përjashtohen nga tarifat gjyqësore. Janë disa OJQ që ofrojnë ndihmë ligjore në mënyrë të pavarur, por skema e tyre nuk ofron mbështetje të qëndrueshme për gazetarët që kanë nevojë për ndihmë juridike falas. Reagimi i Policisë ndaj kërcënimeve të raportuara në përgjithësi ka qenë i kënaqshëm për sa i përket regjistrimit, por ndjekja e rasteve të raportuara është e ngadaltë dhe joefikase, veçanërisht në rastet e sulmeve online dhe të gjuhës së urrejtjes. Rastet që i kalojnë Prokurorisë shpesh pushohen pa u hetuar fare ose vonohen. Shqetësim është edhe niveli i ulët i raportimit të rasteve nga vetë gazetarët. Veprimet konkrete për të trajtuar sulmet ndaj gazetarëve kanë qenë të kufizuara dhe mekanizmat për llogaridhënien dhe mbledhjen e të dhënave janë të pamjaftueshëm. Ka pasur raste edhe të ndalimeve të paligjshme dhe pengimit të punës së gazetarëve ku janë përfshirë punonjës të policisë, gjë që nxjerrë në pah vështirësi të tjera me të cilat përballen gazetarët.

Nuk ka asnjë ndryshim në vitin 2022 për sa i përket mekanizmave për raportimin e gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve serioze për jetën. Institucionet përkatëse shtetërore në Shqipëri nuk i kanë krijuar ende mekanizmat efikasë dhe të posaçëm përmes të cilëve njerëzit, përfshirë gazetarët dhe aktorët e medias, të mund të raportojnë lehtësisht dhe pa vonesa gjuhën e urrejtjes dhe kërcënimet serioze për jetën. Ndonëse ekziston një numër urgjence pa pagesë (112) i krijuar nga Ministria e Brendshme që lidh qytetarët me Policinë e Shtetit në raste urgjente, ai nuk është krijuar posaçërisht për denoncimin e gjuhës së urrejtjes ose kërcënimeve serioze

për jetën. Kjo linjë telefonike ka për qëllim t'i shërbejë të gjithë popullsisë në situata urgjence ose kur kërcënohen nga një krim dhe mund të mos trajtojë në mënyrë efektive nevojat specifike të gazetarëve. Për më tepër, nuk ka asnjë linjë telefonike të posaçme të krijuar nga Ministria e Brendshme për të denoncuar gjuhën e urrejtjes. Gjithsesi, Policia e Shtetit ka punuar për ngritjen e kapaciteteve dhe ka organizuar aktivitete ndërgjegjësuere për gjuhën e urrejtjes nëpërmjet projekteve të financuara nga donatorët që në vitin 2021.

Për sa i përket ndihmës ligjore, legjislacioni aktual (Ligji Nr. 111/2017) nuk i përfshin gazetarët apo punonjësit e mediave si përfitues të posaçëm të ndihmës ligjore falas apo përjashtimit nga tarifat gjyqësore. Si rezultat, nuk ka asnjë shërbim të specializuar që t'u ofrohet gazetarëve në kuadër të shërbimeve të ofruara nga shteti. Gjithsesi, në këtë fushë veprojnë disa OJQ që janë të pavarura nga shërbimet shtetërore dhe që operojnë kryesisht me financim nga donatorë për të ofruar ndihmë ligjore për gazetarët dhe punonjësit e mediave. Një skemë e tillë nuk është e përshtatshme.

Për sa i përket gjuhës së urrejtjes, në Raportin e Pluralizmit të Mediave 2022 thuhet se qytetarët shqiptarë kanë tre mënyra kryesore për të bërë ankesa në lidhje me përmbajtjen në media: Këshilli i Ankesave i Autoritetit të Mediave Audiovizive që trajton çështje që lidhen me gjuhën e urrejtjes në mediat audiovizive; Komisioneri për Mbrojtjen Kundër Diskriminimit që konsiderohet si mekanizmi më i lehtë dhe më efikas për përdoruesit, pavarësisht se fokusi i tij është i kufizuar në disa kategori që mbrohen nga ligji kundër diskriminimit; dhe Bordi i Aleancës për Median Etike, një organ vetë-rregullues i përbërë nga rreth 30 media shqiptare online të angazhuara ndaj Kodit të Etikës së Gazetarëve, që ka një shtrirje të kufizuar për shkak të numrit të vogël të mediave që janë anëtare të saj por që dhe vendimet e tij shpesh nuk merren parasysh. Në vitin 2020, Shqipëria krijoi "Aleancën kundër gjuhës së urrejtjes", e përbërë nga Avokati i Popullit, Komisioneri Kundër Diskriminimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe OJQ-ja, Këshilli Shqiptar i Medias. Pavarësisht krijimit të saj për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin, suksesi i kësaj aleance në rritjen e ndërgjegjësimin dhe numrit të ankesave ka qenë i kufizuar.

Ndonëse nuk ka të statistika të posaçme se sa gazetarë kanë raportuar nëpërmjet këtyre mekanizmave kërcënimet ndaj tyre, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt ka regjistruar disa raste kërcënimesh dhe sulmesh. Në vitin 2022, u raportuan nëntë raste me sulme fizike dhe një kërcënim jete ndaj një grupi xhirimi të Emisionit Investigativ "Fiks Fare". Nga këto incidente, tre u raportuan nga gazetarët përmes linjës pa pagesë të urgjencës. Policia e Shtetit iu përgjigj menjëherë këtyre rasteve duke dërguar efektive në vendngjarje. Përveç kësaj, gazetarët kanë mundësinë (ashtu si edhe qytetarët) të denoncojnë direkt në rajonet e policisë problemet apo kërcënimet që u bëhen. Është e rëndësishme të theksohet se ndonëse mekanizmat aktualë ofrojnë rrugë për denoncim,

ekziston nevoja për kanale më gjithëpërfshirëse dhe të posaçme të përshtatura në mënyrë të veçantë për nevojat unike të gazetarëve dhe aktorëve të medias për trajtimin e gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve serioze për jetën. Është po aq e rëndësishme të theksohet se sulmet e tjera aktuale kundër gazetarëve në vitin 2022 kishin të bënim me ndalim të paligjshëm ose pengim të punës nga vetë efektivet e policisë.

Reagimi i Policisë ndaj kërcënimeve të raportuara në përgjithësi ka qenë i kënaqshëm për sa i përket regjistrimit të denoncimeve. Megjithatë, ka mangësi të konsiderueshme kur bëhet fjalë për kryerjen e hetimeve të plota, veçanërisht në rastet e sulmeve online dhe gjuhës së urrejtjes. Raportet dhe intervistat e shumta tregojnë se masat e mëtejshme, si hetimet që duhet të kryhen nga prokuroria dhe ndëshkimi i autorëve, janë të ngadalta dhe joefektive. Ndonëse institucionet shtetërore i pranojnë dhe përpunojnë denoncimet e gazetarëve për shkeljet e të drejtave, burimet dhe kapacitetet e tyre të kufizuara shpesh sjellin si rezultat mungesë reagimi dhe efektiviteti, veçanërisht në trajtimin e kërcënimeve, ngacmimeve online, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit me bazë gjinore që kanë si objektiv gazetarët. Shumë raste ose mbyllen ose shtyhen e vonohen për shkak të mungesës së provave, duke nxjerrë në pah një lidhje të dobët institucionale dhe duke minuar efektivitetin e hetimeve gjithëpërfshirëse.

Një tjetër problem shqetësues është raportimi i pakët i rasteve nga vetë gazetarët tek autoritetet shtetërore. Mungesa e informacioneve apo statistikave të përditësuara për statusin aktual të hetimeve për sulmet ndaj gazetarëve gjatë viteve të fundit e ndërlikon edhe më tej situatën. Informacioni për hetimet në vazhdim shpesh konsiderohet konfidencial ose fshihet qëllimisht me justifikimin e sekretin hetimor, duke e bërë edhe më të vështirë vlerësimin e progresit të bërë.

Në vitin 2022, edhe pse që autoritetet publike i kanë dënuar sulmet ndaj gazetarëve si shkelje të lirisë së shprehjes, veprimet konkrete për të trajtuar këto çështje kanë qenë të kufizuara. Policia ka treguar një reagim relativisht të shpejtë ndaj sulmeve publike, por veprimet e mëtejshme hetimore kanë qenë të pamjaftueshme. Mungesa e vazhdueshme e llogaridhënies dhe mosndëshkimi për ata që janë përgjegjës për dhunën ndaj gazetarëve janë një shqetësim serioz. Për më tepër, mosmbledhja në mënyrë sistematike dhe të institucionalizuar e të dhënave për sulmet kundër gazetarëve pengon monitorimin efikas dhe hartimin e strategjive që synojnë të luftojnë këto problematika.

Është me rëndësi të madhe të theksohet se përveç rasteve të raportuara të kërcënimeve, ka pasur edhe incidente të shoqërimit apo ndalimit të paligjshëm të punonjësve të medias dhe pengimit të punës së tyre, ku janë përfshirë vetë punonjës të policisë. Këto raste nxjerrin edhe më në pah vështirësitë me të cilat përballen gazetarët në Shqipëri dhe përbëjnë shqetësim për marrëdhëniet mes gazetarëve dhe autoriteteve të zbatimit të ligjit.

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias (jeta ose integriteti fizik i të cilëve janë në rrezik real dhe të menjëhershëm) kanë akses te mekanizma të posaçëm mbrojtjeje/sigurie

Pikët për 2021: 2,78 / Pikët për 2022: 2,78

Legjislacioni shqiptar nuk ofron garanci dhe mekanizma të posaçëm mbrojtjeje për sigurinë e gazetarëve dhe të aktorëve të tjerë të mediave që mund të jenë në rrezik. Mekanizmat ekzistues, si p.sh., mekanizmi i mbrojtjes së viktimave, nuk janë përshtatur për nevojat dhe specifikat e sfidave me të cilat përballen gazetarët. Të dhënat e mbledhura për këtë raport tregojnë se në vitin 2022 nuk ka pasur asnjë rast ku gazetarët të jenë regjistruar dhe të kenë përfituar nga mekanizmi i mbrojtjes së viktimave. Megjithatë, ekzistojnë forma të tjera mbështetjeje që janë në dispozicion të gazetarëve, si ndihma juridike falas e ofruar nga organizata të shoqërisë civile në vend dhe ato ndërkombëtare si dhe nga avokatët e lirisë së medias. Me këto forma u ofrohet ndihmë dhe mbrojtje gazetarëve për të kapërcyer sfidat ligjore dhe për garantimin e sigurisë së tyre. Gjithsesi, është ende e nevojshme të krijohen mekanizma sigurie të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura që të trajtojnë posaçërisht rreziqet e pazakonta me të cilat përballen gazetarët dhe aktorët e medias në Shqipëri.

Në këtë tregues nuk ka ndryshime për vitin 2022. Në nivel kombëtar në Shqipëri mungojnë mekanizmat e posaçëm të sigurisë për mbrojtjen e gazetarëve, veçanërisht atyre që raportojnë për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Edhe pse ka dispozita për mbështetjen dhe mbrojtjen ligjore për sinjalizuesit në rastet e denoncimit të korrupsionit, këto dispozita kufizohen vetëm tek individë që kanë marrëdhënie aktuale ose të mëparshme pune me subjektin që dyshohet se është përfshirë në praktika korruptive. Kur sinjalizimi bëhet publik, sipas këtij ligji personi nuk ka më të drejtën e mbrojtjes që u jepet sinjalizuesve nga ky ligj, gjë që nuk është në përputhje me Direktivën e BE-së dhe

Rekomandimin e Komitetit të Ministrave që parashikojnë mbrojtjen e sinjalizuesit pavarësisht denoncimit publik.

Për më tepër, programi për mbrojtjen e viktimave për qytetarët, veçanërisht për gratë viktime të dhunës në familje, nuk synon në mënyrë specifike gazetarët apo punonjësit e medias. Në procesin e marrjes së një urdhri mbrojtjeje për viktimat e kërcënimeve apo të dhunës me bazë gjinore apo në familje hasen mjaft pengesa. Po ashtu, Ligji "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", në fuqi që nga viti 2009, nuk përfshin gazetarët që raportojnë për akte korrupsioni apo krimin e organizuar nëse nuk bëjnë pjesë në kategoritë specifike të dëshmitarëve apo bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Këto kufizime nxjerrin në pah nevojën për ngritjen e mekanizmave të posaçme të sigurisë të përshtatura për rreziqet unike me të cilat përballen gazetarët që mbulojnë korrupsionin ose krimin e organizuar. Kuadri ligjor në fuqi nuk u siguron mbrojtje të plotë gazetarëve në këto rrethana dhe ka mungesë programesh apo nismash të veçanta për të trajtuar në mënyrë efektive problemet e sigurisë.

Sipas gjetjeve të këtij raporti, është më se e qartë se autoritetet shtetërore në Shqipëri nuk kanë hartuar procedura sistematike dhe të mirë integruara për vlerësimin e rrezikut që kanos gazetarët dhe punonjësit e mediave. Mungesa e procedurave të tilla nxjerr zbulura mangësitë e theksuara të masave gjithëpërfshirëse për vlerësimin dhe trajtimin e problemeve të sigurisë me të cilat përballen individët në industrinë e medias. Ky boshllëk në praktikat dhe kulturën e punës së autoriteteve shtetërore nxjerr në pah nevojën për hartimin dhe zbatimin e protokolleve të posaçme ku i jepet përparësi vlerësimit të rrezikut me të cilin përballen gazetarët dhe punonjësit e medias.

Mekanizmat aktualë për mbrojtjen e viktimave dhe të sigurisë të përcaktuara në ligj nuk janë të përshtatur specifikisht për trajtimin e nevojave të gazetarëve, duke sjellë kështu dobësi në mbrojtjen e gazetarëve dhe mundësi të kufizuara për transferimin e tyre brenda vendit. Janë bërë përpjekje për rritjen e nivelit të sigurisë së gazetarëve nëpërmjet nismave të ndryshme të shoqërisë civile.

Gazetare gra kanë akses te masat ligjore dhe mekanizmat e mbështetjes kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore

Pikët për 2021: 3,49 / Pikët për 2022: 3,49

Ndonëse Shqipëria e ka ratifikuar Konventën e Stambollit dhe i raporton rregullisht Këshillit të Evropës për zbatimin e saj, zbatimi efektiv i kësaj konvente ka ende rrugë të gjatë përpara. Megjithatë, mungesa e të dhënave të ndara sipas rasteve ku viktimat të dhunës, kërcënimeve apo ngacmimeve seksuale janë gazetare femra krijon premisa për minimizimin e fenomenit në sytë e autoriteteve përgjegjëse. Mekanizmat aktualë trajtojnë kryesisht mbështetjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunën me bazë gjinore, por ato janë të fragmentuara, me mangësi në burime dhe të papërshtatura për sfidat dhe kërcënimet me të cilat përballen gazetaret femra në punën e tyre. Shqetësim serioz është ngacmimi seksual duke qenë se gazetaret femra hezitojnë të raportojnë raste të tilla dhe institucioneve u mungojnë kapacitetet e nevojshme për t'u marrë me to.

Konventa e Stambollit, që është e inkuadruar tashmë në legjislacionin shqiptar që në vitin 2014, ofron kuadrin ligjor për trajtimin e dhunës dhe ngacmimit me bazë gjinore. Megjithatë, është e nevojshme të harmonizohen legjislacioni dhe politikat me dispozita të veçanta të Konventës dhe të punohet për zbatimin efikas të tyre. Në rekomandimet e raportit të vlerësimit të GREVIO të vitit 2017 theksohen fushat për përmirësim, si zgjerimi i përkufizimit të dhunës në familje, përmirësimi i mbledhjes së të dhënave për dhunën ndaj grave, përfshirë dhunën ndaj grave në statistikën e krimit, dhe trajtimi i barrierave që i pengojnë viktimat të përfitojnë nga ndihma juridike civile.

Pavarësisht progresit, barazia gjinore ende nuk është integruar plotësisht dhe gjuha e përdorur në kuadrin ligjor nuk është përcaktuese në aspektin gjinor. Nga të dhënat e disponueshme të vitit 2022 evidentohen raste të shumta të ngacmimeve të supozuara seksuale dhe nivelit të lartë të dhunës në familje ndaj grave. Megjithatë, të dhënat nuk mbledhen në të gjithë sistemin dhe nuk janë të ndara sipas gjinisë me qëllim që të

fokusohen tek gratë gazetare si viktime të dhunës. Për sa i përket ngacmimit në vendin e punës, Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” njeh ngacmimet për shkak të gjinisë.

Janë bërë përpjekje për trajtimin e dhunës ndaj grave përtej aspektit të dhunës në familje, ku janë prezantuar masa mbrojtëse për martesën e detyruar, ngacmimin seksual dhe dhunën seksuale. Gjithsesi, është e nevojshme të mblidhen dhe analizohen të dhëna në mënyrë më gjithëpërfshirëse për të kuptuar më mirë sfidat specifike me të cilat përballen gratë gazetare dhe për të krijuar mekanizma të posaçme mbështetëse për to.

Efektiviteti i masave ekzistuese mbrojtëse të përcaktuara në legjislacionin shqiptar është vënë në pikëpyetje, siç dëshmohet nga numri i grave të vrarë nga partnerët e tyre në vitin 2022. Ndonëse politikat njohin natyrën gjinore të dhunës ndaj grave, është më se e nevojshme të vijohet më tej me përpjekjet për të forcuar mbrojtjen dhe për të rritur mbështetjen që u duhet dhënë grave gazetare, të cilat përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore.

Institucionet shtetërore ofrojnë ndihmë juridike falas për të gjitha viktimat e dhunës në familje si dhe për ato të ngacmimeve seksuale apo trafikimit të qenieve njerëzore në kuadër të një procedimi penal. Kjo dispozitë është parashikuar në Nenin 11, gjerat “a” dhe “b”, të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Sipas interpretimit të këtij ligji, kategoritë e përfituesve që marrin ndihmë juridike shtetërore janë shtetasit me të ardhura të pamjaftueshme, grupe të tjera vulnerabël, si personat me aftësi të kufizuara, të miturit, ata që bëjnë pjesë në skemat e mbrojtjes sociale, personat e diskriminuar sipas konkluzioneve nga autoriteti kompetent.

Për të siguruar akses të barabartë në drejtësi, Ministria e Drejtësisë ka ngritur Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. Detyra kryesore e kësaj drejtorie është të bëjë të mundur ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti për të gjithë individët. Po ashtu, është publikuar edhe një manual online në shqip për mënyrat e marrjes së ndihmës juridike falas. Janë një sërë OJQ të ndryshme që e ofrojnë këtë ndihmë për qytetarët në nevojë.

Është me rëndësi të theksohet se edhe ndihma juridike që ofrohet falas për kategori të ndryshme viktimash, përfshirë ato të dhunës në familje, të ngacmimeve seksuale ose trafikimit të qenieve njerëzore, fokusi specifik tek gratë gazetare si përfituese të këtyre shërbimeve nuk përmendet shprehimisht në informacionet e dhëna. Mund të jetë e nevojshme të bëhen përpjekje të mëtejshme për të bërë të mundur që gratë gazetare të kenë akses në ndihmën e nevojshme dhe të mjaftueshme ligjore dhe mekanizmat e mbrojtjes, të përshtatura posaçërisht për sfidat dhe përvojat e tyre unike.

Shqipëria nuk ka një sistem të konsoliduar apo shërbim mbështetës që të ofrojë informacione të vazhdueshme

për masat e sigurisë, këshillime ligjore apo informacione të tjera për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Shërbimet mbështetëse në këtë fushë janë të fragmentuara, ku viktimës i kërkohet të komunikojë me institucione të ndryshme për të marrë një mbështetje të tillë, gjë që krijon premisa për riviktimizimin e saj. Për shembull, Kodi i Procedurës Penale parashikon të drejtën e viktimës për të marrë informacion sipas kërkesës për ecurinë e procesit, por në fazën e hetimit nga prokuroria, edhe viktima është e kufizuar nga aksesit në informacion me justifikimin e sekretit hetimor.

Shërbimet sociale vendore, në bashkëpunim me OJQ-të, ofrojnë një farë mbështetjeje për masat e sigurisë për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Mekanizmat vendorë të referimit funksionojnë në nivel bashkie, duke synuar t'i japin një përgjigje të fortë të unifikuar dhunës në familje. Megjithatë, këto mekanizma fokusohen kryesisht te mbështetja që i duhet dhënë viktimave të dhunës në familje dhe mund të mos jenë të pajisur tërësisht për të trajtuar vështirësitë specifike që hasin gratë gazetare. Stafi i shërbimeve sociale në vijën e parë dhe stafi vendor nuk janë të trajnuar dhe plotësisht të përgatitur për të ofruar mbështetje dhe këshilla profesionale për gazetaret femra.

Në vitin 2021 Policia vuri në punë një proces të automatizuar për bërjen e aplikimeve brenda sistemit të menaxhimit të rasteve policore që mundësonte nxjerrjen e shpejtë të urdhrave mbrojtës dhe i regjistroi ato sipas Indeksit të të Drejtave të Njeriut. Po ashtu, në prill 2021 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miratoi një protokoll për funksionimin e qendrave për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit gjatë pandemisë COVID-19.

Një tjetër mekanizëm i disponueshëm në Shqipëri është Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, një institucion i pavarur i mandatuar nga Kuvendi. Misioni i tij është të sigurojë mbrojtje efektive kundër diskriminimit dhe çdo forme sjelljeje që nxit diskriminimin. Kompetencat e tij janë të ndryshme përfshirë trajtimin e ankimeve, vendosjen e sanksioneve administrative, ngritjen e padive në gjykatë për mbrojtjen e viktimave të diskriminimit, hetimin administrativ të çështjeve të diskriminimit sipas detyrës zyrtare kur ka të dhëna publike. Edhe pse këto detyra duhet të kryhen për çdo shtetas në Shqipëri, përfshirë edhe gazetaret femra që janë të diskriminuara për shkak të gjinisë, mbështetja e posaçme për gratë gazetare në kuadër të këtij ligji nuk është e shprehur në mënyrë të qartë.

Është me rëndësi të theksohet se pavarësisht ekzistencës së tyre, këto mekanizma kanë nevojë të konsolidohen dhe të përmirësohen më tej për të bërë të mundur ofrimin e një mbështetjeje të gjithanshme dhe efikase për viktimat e dhunës gjinore, përfshirë këtu edhe gazetaret.

Ndonëse legjislacioni në fuqi i ndalon ngacmimet seksuale, ka mjaft të meta në zbatimin e tij nga organet ligjzbatuese. Gazetaret femra, në veçanti, shpesh hezitojnë t'u drejtohen

institucioneve për të denoncuar ngacmimet apo kërcënimet, veçanërisht kur bëhet fjalë për ngacmimet seksuale në vendin e punës. Për shkak të profesionit të tyre, duke njohur dobësitë e sistemit institucional në parandalimin, referimin dhe trajtimin e dhunës me bazë gjinore, sjell një efekt dekurajues për t'iu drejtuar këtyre institucioneve kur ato vetë janë viktimat të kësaj dhune. Kritikën ndaj institucioneve shtetërore në përgjithësi për shkak të profesionit i bënë këto gra të ndjehen të pambrojtura në raport me to kur kanë nevojë për shërbime të tilla për shkak të frikës nga riviktimizimi i mundshëm.

Edhe pse gazetaret që diskriminohen ose ngacmohen në redaksi në Shqipëri kanë mundësinë të kërkojnë ndihmë nga institucionet shtetërore, si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe të denoncojnë në polici rastet e diskriminimit për shkak të gjinisë dhe ngacmimit, mundësitë për ta bërë këtë janë shumë të pakta. Studimet e kohëve të fundit tregojnë se gazetaret ndiheshin nën presion nga eprorët meshkuj dhe disa prej tyre ishin në dijeni të rasteve kur koleget e tyre ishin ngacmuar seksualisht në punë. Megjithatë, gazetaret zakonisht nuk flasin hapur për rastet e ngacmimeve seksuale apo në mbështetje të kolegeve kur ato bëhen pre e ngacmimeve apo kur raportohen raste të tilla.

Është krijuar praktika e rregullt e dënimit publikisht të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave

Pikët për 2021: 2,73 / Pikët për 2022: 2,73

Praktika e dënimit publik dhe e distancimit nga kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave nuk është ende e rregullt dhe e plotë. Edhe pse ka pasur raste kur autoritetet publike kanë dënuar publikisht kërcënime dhe sulme të tilla si shkelja e lirisë së shprehjes, shpeshtësia dhe vazhdimësia e këtyre dënimeve mbeten të kufizuara. Ka ende nevojë të ndërmerret një qasje më sistematike dhe më e rregullt për të dënuar publikisht akte të tilla, duke theksuar seriozitetin e tyre dhe rëndësinë e mbrojtjes së gazetarëve dhe punonjësve të medias.

Praktika e dënimit publikisht të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të medias në Shqipëri realizohet me hope dhe shpesh nxitet nga interesat ose përfitimet politike. Ndonëse disa autoritete publike i kanë denoncuar dhe dënuar si shkelje të lirisë së shprehjes sulme të tilla, reagimeve të tyre u mungojnë veprimet konkrete për t'i trajtuar çështjet që në themel. Policia ka reaguar relativisht shpejtë ndaj sulmeve publike, por hetimet e mëpasshme janë të kufizuara dhe jo gjithëpërfshirëse dhe përgjithësisht ndërmerren me vonesë. Në përgjithësi mungojnë ndjekja penale dhe ndëshkimi i personave përgjegjës për dhunën ndaj gazetarëve. Mungesa e mbledhjes sistematike të të dhënave për sulmet ndaj gazetarëve pengon përpjekjet e mëtejshme për t'i monitoruar dhe trajtuar këto çështje me efektivitet. Krijimi i një praktike më të qëndrueshme dhe më të institucionalizuar të dënimit publikisht të sulmeve, së bashku me procedurat dhe masat e konsoliduara hetimore për ndëshkimin e autorëve përgjegjës, janë me rëndësi për forcimin e lirisë së shtypit dhe garantimin e sigurisë së gazetarëve në Shqipëri.

Dënimi publikisht i sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve në Shqipëri ndikohet nga dinamika politike, ku kemi reagime të ndryshme nga politikanë me influencë dhe nga partitë politike. Partia Demokratike, si partia kryesore opozitare, tenton të jetë më e zëshme në dënimin publikisht të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe fajëson përherë qeverinë dhe Partinë Socialiste në pushtet për rënien e lirisë së

medias. Nga ana tjetër, politikanët e nivelit të lartë të Partisë Socialiste dhe zyrtarët publikë të lidhur me këtë të fundit përgjithësisht prirën t'i zvogëlojnë përmasat e këtyre rasteve.

Kjo qasje partiake ndaj dënimit publikisht të kërcënimeve dhe sulmeve nxjerr në pah politizimin e lirisë së medias dhe sfidat për arritjen e një qëndrimi të unifikuar dhe të qëndrueshëm për mbrojtjen e gazetarëve. Është me rëndësi të madhe që drejtuesit politikë të të gjithë spektrit t'i japin përparësi sigurisë dhe mirëqenies së gazetarëve, pavarësisht përkatësisë së tyre politike, dhe t'i dënojnë pa rezerva kërcënimet dhe sulmet, në mënyrë që të nxisin klimën e lirisë së shtypit dhe të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve.

Sfidat me të cilat përballen gazetarët në Shqipëri shkojnë përtej presionit të drejtpërdrejtë nga qeveria dhe pushtetarët. Ato vijnë edhe nga marrëdhëniet e ndërlikuara dhe të ndërsjella mes pronarëve të mediave, politikanëve dhe grupeve të fuqishme të interesit. Presioni i tërthortë mbi gazetarët ushtrohet nëpërmjet strategjive që synojnë të minojnë besueshmërinë dhe rëndësinë e gazetarisë profesionale, të tilla si fushatat e shpifjeve dhe debatet kundër medias. Në këtë mjedis kontribuojnë veprimet e qeverisë, veprime që zhvlerësojnë rolin e medias. Për më tepër, gazetarët përballen me kërcënime të tjera në formën e padive për shpifje dhe kërcënimeve me padi gjyqësore, veçanërisht kur përfshihen në gazetari investigative. Siguria dixhitale është një tjetër shqetësim, pasi gazetarët janë të cenueshëm ndaj shkeljeve të të dhënave dhe rreziqeve të tjera të sigurisë kibernetike. Këto sfida të formave të ndryshme nxjerrin në pah nevojën për marrjen e masave të gjithanshme për mbrojtjen e pavarësisë, sigurisë dhe integritetit të punës së gazetarëve. Përpjekjet duhet të përqendrohen në nxitjen e një klime që vlerëson dhe mbështet rolin e padiskutueshëm të gazetarisë në një shoqëri demokratike.

Organet e policisë janë të ndjeshme ndaj çështjes së mbrojtjes së gazetarëve

Pikët për 2021: 3,10 / Pikët për 2022: 2,94

Në vitin 2022, janë bërë përpjekje për rritjen e numrit të trajnimeve dhe nivelit të ndërgjegjësimit të punonjësve të policisë në lidhje me ndërveprimin e tyre me gazetarët dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Megjithatë, miratimi i protokolleve zyrtare për të gjithë sistemin mbetet i kufizuar. Edhe pse në përgjithësi zyrtarët shtetërorë janë prirur t'i dënojnë sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve dhe ku policia ka përmirësuar reagimin e saj, kufizimet në kryerjen e hetimeve administrative dhe penale për incidentet vazhdojnë të mbeten. Vihet re një përkeqësim i lehtë në numrin e incidenteve të raportuara në vitin 2022 të shoqërimit të paligjshëm të gazetarëve ose ndalimit të pajustificuar të tyre, konfiskimit të pajisjeve dhe keqtrajtimit të gazetarëve gjatë protestave dhe ngjarjeve të tjera.

Në vitin 2022, janë bërë përpjekje për rritjen e numrit të trajnimeve dhe nivelit të ndërgjegjësimit të punonjësve të policisë në lidhje me ndërveprimin e tyre me gazetarët dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe rolit të jashtëzakonshëm të gazetarëve në një shoqëri demokratike. Megjithatë, miratimi i protokolleve zyrtare për të gjithë sistemin mbetet i kufizuar. Me mbështetjen e donatorëve të huaj janë organizuar trajnime me efektive policie dhe gjyqtarë ku janë mbuluar tema të tilla si siguria e gazetarëve, siguria online, gjuha e urrejtjes dhe ngacmimi. Edhe pse këto trajnime janë më se të dobishme, ka ende nevojë për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve dhe marrjen e nismave ndërgjegjësuese për të bërë të mundur që të kuptohen dhe të zbatohen sa më drejt praktikatat më të mira në marrëdhëniet me gazetarët. Me vazhdimin e investimeve në programe të tilla trajnimi dhe me nxitjen e një kulture respekti për lirinë e medias, synimi është të krijohet një mjedis ku gazetarët të mund të punojnë të lirë dhe të sigurt.

Përgjithësisht vihet re se në vitin 2022, sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve dënohen nga zyrtarët shtetërorë, të cilët i konsiderojnë këto sulme si shkelje të lirisë së shprehjes. Reagimi i policisë është përmirësuar në trajtimin publikisht të këtyre rasteve. Megjithatë, hetime administrative nga Shërbimi


i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesa apo hetimet penale nga Prokuroria janë në numër tejet të kufizuar. Institucionet e pavarura, si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave, kanë bashkëpunuar me organizatat e gazetarëve për trajtimin e problemeve të sigurisë së gazetarëve. Duhet evidentuar se edhe Prokuroria e Përgjithshme dhe Policia kanë bashkëpunuar edhe me organizatat e gazetarëve për çështje që lidhen me sigurinë e këtyre të fundit.

Sipas të dhënave e mbledhura nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt, në vitin 2022 ka pasur incidente që përbëjnë shqetësim për vëmendjen e pakët që i kushtohet sigurisë së gazetarëve nga disa efektivë policie në Shqipëri. Për shembull, gazetari Sami Curri u shoqërua në Komisariatin e Bulqizës teksa mbulonte një protestë kundër rritjes së çmimit të naftës dhe të ushqimeve. Fotografit Gent Shkullaku i konfiskua aparati fotografik gjatë përplasjeve mes policisë dhe tifozëve të futbollit. Gazetarët që mbulonin protestat kundër rritjes së kostove në shumë qytete u përballën me dhunën e policisë, me të paktën dy gazetarë të sulmuar fizikisht në Tiranë dhe Durrës. Gjithashtu, gazetari Ledio Guni u dëbua forcërisht nga policia teksa dokumentonte shembjen e banesave të qytetarëve në Lagjen "5 Maji" në Tiranë. Dhunë pësoi edhe Sonila Musai kur u tërhoq zvarrë nga policia teksa raportonte drejtpërsëdrejti për qëndresën e banorëve kundër prishjes së banesave të tyre. Këto incidente tregojnë raste të ndalimit të pajustificuar dhe keqtrajtimin të gazetarëve nga policia. Është e rëndësishme të hetohen dhe trajtohen më tej incidente të tilla për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve në Shqipëri.



Procesi i rregullt

2,60



43

Njësitë dhe/ose oficerët që mbulojnë hetimet e specializuara janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve

Pikët për 2021: 2,96 / Pikët për 2022: 2,96

Pavarësisht ndërgjegjësimit në përgjithësi për rëndësinë e mbrojtjes së gazetarëve, në Shqipëri agjencitë e zbatimit të ligjit hasin ende në vështirësi për sa i përket përvetësimit të njohurive, kapaciteteve dhe sigurimit të burimeve për të hetuar me efikasitet sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve. Në Kodin Penal mungojnë dispozita të qarta që të garantojnë mbrojtje të veçantë për profesionin e gazetarëve në rastet e dhunës apo sulmeve të kryera ndaj tyre për shkak të detyrës. Po ashtu, mungesa e protokolleve të posaçme të hetimeve pengon zbulimin dhe ndjekjen efikase penale të personave përgjegjës për agresionin dhe dhunën ndaj gazetarëve..

Në sistemin e drejtësisë mungojnë njësitë e specializuara të posaçme për hetimin dhe ndjekjen penale të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve. Ndonëse ka pasur nisma trajnimi për përmirësimin e njohurive dhe rritjen e ndërgjegjësimit tek agjencitë e zbatimit të ligjit, këtyre të fundit ende u mungojnë burimet e nevojshme për të hetuar me efektivitet sulmet dhe dhunën që kanë si objekt gazetarët. Nga ana tjetër, disa institucione shtetërore kanë organizuar trajnime për trajtimin e gazetarëve dhe profesionistëve të medias, por vetëm një numër i kufizuar i tyre kanë të miratuar protokolle zyrtare. Po ashtu, policia dhe prokurorët kanë njohuritë bazë për veprat penale që lidhen me dhunën dhe sulmet ndaj gazetarëve, por është ende e nevojshme të hartohen dhe zbatohen më tej protokolle gjithëpërfshirëse për trajtimin e këtyre çështje në mënyrë sa më efikase. Rritja e burimeve dhe aftësive të agjencive të zbatimit të ligjit për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të tilla si dhe vendosja e praktikës gjyqësore pozitive në drejtim të hetimeve efektive, objektive

dhe gjithëpërfshirëse janë të një rëndësie të madhe për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së gazetarëve në Shqipëri.

Policia dhe prokurorët në Shqipëri kanë në përgjithësi njohuri të nevojshme për veprat penale që lidhen me dhunën dhe sulmet ndaj gazetarëve, pasi këto vepra janë të njëjta për të gjithë shtetasit e tjerë. Ndryshe nga dispozitat e Kodit Penal që parashikojnë mbrojtje të veçantë për zyrtarët dhe punonjësit e angazhuar në shërbime publike, në Shqipëri nuk ka një praktikë gjyqësore për të përcaktuar qartë se cilët janë punonjësit e angazhuar në shërbimet publike dhe nëse gazetarët janë pjesë e tyre. Rrjedhimisht, edhe pse është një profesion tejet i rëndësishëm në sferën private, gazetarët në praktikë nuk përfitojnë nga dispozitat ligjore apo nga vepra të caktuara penale që lidhen me sulmet kundër tyre për shkak të detyrës apo profesionit. Për më tepër, nuk ka udhëzime të përcaktuara qartë apo të institucionalizuara për të siguruar zbulimin dhe ndjekjen efikase të agresionit dhe dhunës veçanërisht ndaj gazetarëve. Këto raste hetohen në kuadër të praktikave të zakonshme të hetimit dhe, fatkeqësisht, në tre vitet e fundit nuk është zgjidhur asnjë rast i rëndë sulmi ndaj gazetarëve. Është me rëndësi të madhe të trajtohen këto mangësi në mbrojtjen ligjore dhe të merren masa efektive për të garantuar sigurinë e gazetarëve në Shqipëri.

Ndonëse ka një farë bashkëpunimi mes institucioneve kompetente në Shqipëri në lidhje me hetimet, vihet re se mungon një protokoll i posaçëm për gazetarët. Kjo do të thotë se nuk janë hartuar udhëzimet apo procedura të standardizuara që të trajtojnë posaçërisht sfidat e pazakonta dhe rreziqet me të cilat përballen gazetarët në punën e tyre. Si rezultat, hetimeve dhe reagimeve ndaj sulmeve dhe kërcënimeve kundër gazetarëve u mungon qasja e koordinuar në nivel sistemi.

Hetimet për sulme të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë efikase (të pavarur, të plotë dhe të menjëhershme)

Pikët për 2021: 2,61 / Pikët për 2022: 2,61

Sulmet fizike kundër gazetarëve gjatë viteve të fundit mbeten ende të pazgjidhura dhe hetimet janë të ngadalta dhe joefikase ose pushohen plotësisht. Mungesa e progresit në lidhje me këto hetime ngre shqetësime për efektivitetin e punës së agjencive të zbatimit të ligjit në trajtimin e sulmeve ndaj gazetarëve. Për më tepër, mungesa e praktikave të rregullta të komunikimit institucional për raste të tilla dhe parimi i sekretit hetimor që është i decentralizuar sipas modelit të punës së secilit prokuror të ngarkuar me hetim kufizojnë edhe më shumë transparencën, pasi procese të tilla marrin shumë kohë, janë të ngadalta dhe informacioni publik për to është i kufizuar.

Ashtu si edhe në vitet e mëparshme, në raport theksohet se është bërë shqetësuese tendenca e moszgjidhjes së rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve në tre vitet e fundit, duke nxjerrë në pah mungesën e hetimeve të thelluara për sulmet fizike ndaj gazetarëve. Është e rëndësishme të theksohet se marrja e informacionit në lidhje me hetimet në vazhdim mund të jetë e vështirë për shkak të parimit të sekretit hetimor që përdoret për këto procedura, duke kufizuar aksesin në dosjen e hetimit të prokurorëve dhe policisë. Mungesa e një komunikimi të rregullt me publikun nga policia dhe prokuroria lidhur me ecurinë dhe përfundimin e këtyre hetimeve kufizon informacionin që është me interes të veçantë për publikun lidhur me punën e këtyre institucioneve në zbardhjen e motiveve të ngjarjes dhe identifikimin e autorëve përgjegjës. Për rrjedhojë, kjo qasje e mbyllur minimizon përgjegjshmërinë institucionale dhe rëndësinë që duhet të ketë për ta integriteti fizik dhe moral i gazetarëve, kur ky integritet kërcënohet nga ngjarje të tilla. Për më tepër, Kodit Penal i mungojnë dispozitat e qarta që do

të siguronin mbrojtje të veçantë për gazetarët kur ata bëhen pre e dhunës apo sulmeve gjatë kryerjes së detyrës. Kjo mungesë e dispozitave të posaçme ligjore ka sjellë si rezultat mungesën e fokusit në hetimin e motivit të krimeve të kryera ndaj gazetarëve dhe vendosjen e një lidhjeje të qartë mes këtyre krimeve dhe detyrës dhe përgjegjësiwe profesionale të gazetarëve. Trajtimi i këtyre çështjeve është me rëndësi të madhe për hetimin e thelluar të sulmeve ndaj gazetarëve dhe garantimin e mbrojtjes së nevojshme që meritojnë ata.

Në raport evidentohen mangësitë dhe vonesat në hetimin e rasteve të rënda të sulmeve fizike kundër gazetarëve në këto pesë vitet e fundit. Mungesa në Kodin Penal të dispozitave të qarta që garantojnë mbrojtje të veçantë për profesionin e gazetarëve në rastet e dhunës apo sulmeve të kryera ndaj tyre për shkak të detyrës ka rezultuar në mungesë të prioritizimit të hetimeve nga ana e prokurorëve. Dështimi në thellimin e hetimeve për motivet e këtyre krimeve përjetëson heshtjen institucionale, duke mohuar të vërtetën për publikun dhe duke penguar vënien para drejtësisë dhe ndëshkimin e plotë të autorëve.

Për më tepër, parimi i sekretit hetimor bëhet pengesë për marrjen e informacionit për hetimet në proces. Sipas Kodit të Procedurës Penale, informacioni në lidhje me çështjen penale mund të merret vetëm nga prokurori i çështjes dhe një decentralizim i tillë i informacionit krijon qasje të ndryshme për marrjen e informacionit zyrtar për këto raste tek prokuroria si institucion. Të dhënat e mbledhura për këtë raport tregojnë se hetimeve për sulmet ndaj gazetarëve shpesh nuk u jepet prioriteti më i lartë, duke sjellë vonesa në afatet procedurale. Burimet dhe kapacitetet e kufizuara të policisë kontribuojnë më tej në mungesën e progresit të hetimeve për këto raste. Si rezultat, trajtimi i sulmeve ndaj gazetarëve nuk është prioritet i vazhdueshëm, duke rrezikuar kështu dhënien e drejtësisë dhe llogaridhënies.

Në shumë raporte evidentohet se hetimi i sulmeve ndaj gazetarëve pengohet nga ngecja e afateve procedurale nga ana e prokurorisë dhe nga mungesa e burimeve dhe kapaciteteve të policisë dhe prokurorisë. Kjo situatë ngre shqetësime për prioritizimin e këtyre rasteve, pasi burimet e kufizuara të akorduara për hetimin e sulmeve ndaj gazetarëve na bëjnë të mendojmë se hetimi i këtyre rasteve nuk shihet gjithmonë me prioritet të lartë. Vonesat që vijnë si rezultat i tyre dhe kufizimet e burimeve minojnë efektivitetin e hetimeve dhe pengojnë dhënien e drejtësisë për viktimat e këtyre sulmeve.

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen me efikasitetet nga format e ndryshme të ngacmimeve online

Pikët për 2021: 2,58 / Pikët për 2022: 2,58

Në legjislacionin shqiptar nuk jepet një përkufizim i plotë për ngacmimin, përfshirë edhe ngacmimin online, ndërkohë që ai parashikon mbrojtje vetëm ndaj ngacmimeve seksuale. Autoritetet shtetërore kanë njohuri, kompetenca, burime dhe procedura të kufizuara për trajtimin dhe mbrojtjen efikase të gazetarëve, veçanërisht gazetarëve, nga ngacmimet online. Ky boshllëk në mbrojtjen ndaj ngacmimeve online, i shoqëruar me kulturën e mosreagimit apo mosraportimit të këtyre rasteve, përbën shqetësim të madh për mirëqenien dhe sigurinë e gazetarëve në Shqipëri.

Kuadri ligjor në Shqipëri e trajton mbrojtjen nga ngacmimi nëpërmjet një sërë ligjesh, ku secili prej tyre ka një përkufizim të vetin. Neni 108/a i Kodit Penal fokusohet te ngacmimet seksuale, ku përfshin çdo sjellje që cenon dinjitetin e një personi e që krijon një mjedis kërcënues e armiqësor për të. Në këtë dispozitë përfshihet edhe ngacmimi seksual online. Po ashtu, Neni 32/a i Kodit të Punës jep një përkufizim të plotë të ngacmimit në marrëdhëniet e punës dhe përcakton edhe detyrimin e punëdhënësit të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar ngacmimet seksuale dhe morale dhe për të garantuar kushte të favorshme pune. Nga ana tjetër, Neni 3, pika 5 e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon mbrojtjen nga ngacmimi për shkaqe diskriminuese me synimin mbrojtjen e dinjitetit të personit dhe garantimin e një mjedisi respektues. Këto ligje së bashku trajtojnë aspekte të ndryshme të ngacmimit, duke evidentuar nevojën e punëdhënësve, individëve dhe shoqërisë si një e tërë për marrjen e masave paraprake për parandalimin dhe trajtimin e sjelljeve të tilla.

Në raport theksohet se nga ana e institucioneve kompetente nuk janë marrë masa të posaçme për trajtimin dhe mbrojtjen e gazetarëve nga ngacmimet online. Në vitin 2022, gratë gazetare ngritën shqetësime për rastet e ngacmimeve seksuale, dhunës online dhe keqinformimit me bazë gjinore. Megjithatë,

— TREGUES 3.3

ka mungesë denoncimesh për këto raste tek autoritetet dhe vetë gazetaret hezitojnë shumë të dalin publikisht dhe të kërkojnë mbështetje. Riviktimizimi prej institucioneve dhe mungesa e besimit tek to janë ndër faktorët që ushqejnë kulturën e mos-denoncimit. Ashtu si me periudhat e mëparshme të raportimit, gratë gazetare raportojnë ngacmimin seksual, dhunën online dhe fushatat e shpifjeve si format kryesore të presioneve me bazë gjinore. Këto probleme theksojnë nevojën për ngritjen e mekanizmave dhe sistemeve mbështetëse efikase me qëllim trajtimin dhe luftimin e këtyre formave të ngacmimit dhe dhunës ndaj grave gazetare.

Hetimet e të gjitha formave të sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente

Pikët për 2021: 2,57 / Pikët për 2022: 2,57

Në përgjithësi, informacioni për publikun si dhe informacioni që i jepet viktimës apo avokatit të tij/saj në lidhje me ecurinë e çështjes dhe provat e mbledhura gjatë hetimeve është shumë i kufizuar. Kjo vjen për shkak të rregullit të zbatuar me rigorozitet të tepruar nga Prokuroria, pa kritere të mirë përcaktuara dhe të qarta për sekretin hetimor. Si rezultat, ka shumë pak tregues që të evidentojnë se për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve ndërmerren hetime duke qenë se shumica e rasteve mbeten të pazgjidhura ose hetimet zvarriten, duke dobësuar ndjeshëm efikasitetin e tyre.

Sipas Nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale, viktima gëzon, ndër të tjera, të drejtën të kërkojë në çdo kohë informacion për fazën e procedimit, si dhe të njihet me aktet dhe provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor. Megjithatë, në praktikë gazetarëve u mohohet e drejta për t'u njohur me aktet dhe provat gjatë hetimit, sepse këto të fundit konsiderohen si sekret hetimor. Kjo mungesë transparence jo vetëm që kufizon aftësinë për të kontribuar në hetime por pengon marrjen e informacioneve të rëndësishme që mund të mbështesin prokurorinë. Ka shumë pak informacione lidhur me hetimet për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve dhe autoritetet nuk japin asnjë përditësim për rastet serioze të sulmeve fizike ndaj gazetarëve. Institucionet e drejtësisë normalisht duhet të kenë rregulla për marrëdhëniet/komunikimin me publikun, por jo gjithmonë ndodh kështu. Këshilli i Lartë Gjyqësor, organi përgjegjës për përcaktimin e standardeve të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median, vetëm në qershor 2023 prezantoi për konsultim një projekt udhëzim ku përcaktohen këto standarde. Ndërkohë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk duket se i ka miratuar këto standarde për komunikimin e prokurorisë me publikun dhe median. Gjithsesi, në vitin 2019, Prokuroria e Përgjithshme nxori një Udhëzim për Marrëdhëniet me Publikun në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm, ku rregullon rolin

e policisë gjyqësore për dhënien apo refuzimin e informacionit që merret gjatë një hetimi. Në përgjithësi, marrëdhëniet e institucioneve të drejtësisë me median rregullohen me dispozita të përgjithshme në ligjin organik të çdo institucioni të drejtësisë.

Zyrat e shtypit pranë gjykatave dhe prokurorive nuk japin informacion të rregullta dhe të sakta për stadin e çështjeve gjyqësore për shkak të mungesës së udhëzimeve dhe mangësive të tjera në organizimin e brendshëm (mbingarkesa për shkak të numrit të lartë të çështjeve të prapambetura, fakti që sistemi është në procesin e vetingut gjë që ka krijuar shumë vende të lira pune dhe ngërçe të tjera, etj.). Siç u përmend edhe më sipër, viktimat kanë të drejtën e njohjes me informacion që ka të bëjë me çështjen e tyre, për sa kohë që kjo nuk cenon sekretin hetimor. Po ashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka nxjerrë edhe Udhëzimin e Përgjithshëm Nr. 05, datë 26.10.2018, që fokusohet në garantimin e ndihmës për viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale. Në këtë udhëzim jepen orientime se si prokurorët dhe policia gjyqësore duhet t'i trajtojnë viktimat, të drejtat që u takojnë atyre, përfshirë këtu edhe mbrojtjen fizike nëse është e nevojshme. Konventa e Stambollit përmendet si një nga bazat ligjore për hartimin dhe miratimin e udhëzimit në fjalë. Megjithatë, niveli i zbatimit të këtij udhëzimi nuk evidentohet lehtësisht.

Autoritetet shtetërore krijojnë sisteme cilësore të mbledhjes së statistikave për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë

Pikët për 2021: 2,28 / Pikët për 2022: 2,28

Në Shqipëri mungon një sistem i besueshëm, i unifikuar dhe sistematik i mbledhjes së të dhënave dhe statistikave për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve. Asnjë nga autoritetet përkatëse shtetërore dhe gjyqësore nuk ka krijuar një sistem të besueshëm dhe të unifikuar për mbledhjen e të dhënave, të ndara sipas kriterëve të ndryshme. Kjo do të thotë se ka mungesë informacioni të besueshëm dhe të vazhdueshëm në lidhje me incidente të tilla. Po ashtu, institucioneve shtetërore kanë kufizime për sa i përket burimeve dhe kapaciteteve për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla, gjë që dëmton edhe më shumë aftësinë e tyre për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla. Si rezultat, nuk kuptohet mirë shtrirja dhe natyra e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve në vend.

Në Shqipëri ka mungesë regjistrimi, analizimi dhe publikimi zyrtar i të dhënave që lidhen veçanërisht me sulmet ndaj gazetarëve dhe mosndëshkimin e këtyre sulmeve. Institucioneve shtetërore përgjithësisht u mungojnë burimet dhe kapacitetet e nevojshme për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla. Në raportin vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme për gjendjen e kriminalitetit në vend evidentohen mangësi të dhënash të ndara në kategori të caktuara dhe të një mekanizmi statistikor të përshtatshëm për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për veprat penale ku viktimat janë gazetarët dhe punonjësit e mediave. Monitorimi dhe raportimi mbi kërcënimet kryhen kryesisht nga Këshilli i Evropës, Reagimi i Shpejtë për Lirinë e Medias dhe Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt. Autoritetet shtetërore u përgjigjen njoftimeve nga Këshilli i Evropës. Mungesa e një sistemi të unifikuar të menaxhimit të çështjeve, përfshirë këtu edhe çështjet penale, e bën të vështirë monitorimin e progresit të tyre, veçanërisht kur këto çështje shkojnë për gjykim në gjykatë. Kjo mungesë aksesit të unifikuar tek të dhënat pengon që publiku të informohet vazhdimisht për të gjithë procesin e hetimit dhe gjykimin, përfshirë statusin dhe fazën e një çështjeje, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës..

IV

Siguria aktuale

2,78

Kërcënime dhe ngacmime jo-fizike

3,37

Kërcënimet kundër jetës dhe
sigurisë fizike të gazetarëve

4,30

Siguria aktuale

3,37

Kërcënime dhe sulme ndaj mediave
dhe shoqatave të gazetarëve

3,84

1.00
2.00
3.00
4.00
5.00
6.00
7.00



Ka raste të rënda të kërcënimeve dhe sulmeve aktuale kundër gazetarëve dhe organizatave të medias, përfshirë vrasjet.

Nuk ka pasur raste të sulmeve aktuale, asnjë kërcënim kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve, as nuk ka pasur kërcënime dhe ngacmime jo fizike kundër gazetarëve dhe mediave.

Kërcënime dhe ngacmime jofizike

Pikët për 2021: 3,60 / Pikët për 2022: 3,67

Në krahasim me vitin 2021, ka pasur një rritje të lehtë të numrit të rasteve serioze të kërcënimeve dhe ngacmimeve jofizike të raportuara në vitin 2022. Ndërkohë që në vitin 2021 janë raportuar vetëm dy raste serioze, në vitin 2022, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt regjistroi gjithsej 6 raste të tilla.

Në vitin 2022, Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt regjistroi 6 raste kërcënimesh dhe ngacmimesh jofizike ndaj gazetarëve në Shqipëri. Këto raste kishin të bënin me një efektive policie, znj. Kostani, që fyeu publikisht gazetarët në rrjetet sociale, gjë që solli si rezultat pezullimin e saj dhe nisjen e një hetimi nga kreu i Policisë së Shtetit, z. Gledis Nano. Kryeministri Edi Rama ndaloj gazetarin Klevin Muka të merrte pjesë në konferencat e ardhshme për shtyp për tre muaj dhe e urdhëroi atë të “riedukohej” kur ky i fundit gjatë një konference për shtyp i bëri një pyetje për konflikt interesash ministres Olta Xhaçka. Gazetari Isa Myzyraj u përball me presion dhe kërcënim për raportimin mbi procesin e vetingut të kryetares së Prokurorisë së Tiranës, Elizabeta Imeraj.

Në një tjetër rast, një noter publik nxori certifikatën familjare dhe një faturë pagese në portalin e-Albania për gazetarin Edmond Hoxhaj dhe bashkëshorten e tij pa dijeninë apo pëlqimin e këtyre të fundit. Gjatë seancës gjyqësore “Dosja 184”, një gjyqtar veproi si kryeredaktor dhe censuroi një reporter të BIRN-it, duke i diktuar atij se si duhej raportuar çështja. Më tej, gjatë një konference të improvizuar për shtyp, kryeministri Edi Rama i tha gazetares Ambrozia Meta të TV Syri.net se ajo kishte nevojë për “riedukim” duke i thënë se nuk do të merrte asnjë pyetje prej saj për 60 ditë me pretendimin se ajo kishte treguar atë që ai e konsideronte si “sjellje joprofesionale”.

Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

Pikët për 2021: 4,26 / Pikët për 2022: 4,30

Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve bëhen si në mënyrë të fshehtë ashtu edhe haptazi, ndërkohë që vetëm një rast u regjistrua për vitin 2022 në krahasim me disa raste të raportuara për vitin 2021 nga Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt dhe platforma të tjera ndërkombëtare për lirinë e medias. Megjithatë, raste të tilla nuk janë të vazhdueshme.

Teksa raportonin jashtë perimetrit të Firmës Ovital në fshatin Sukth, Durrës, ku ishin gruposur pula të ngordhura në zonat e banuara përreth, disa njerëz që deklaruan se ishin përfaqësues të firmës thyen kamerën e kameramanit dhe kërcënuan me jetë gazetarin e Emisionit Investigativ "Fiks Fare".

Sulmet aktuale

Pikët për 2021: 3,43 / Pikët për 2022: 3,37

Gjatë vitit 2022 në Shqipëri janë regjistruar nëntë raste të sulmeve aktuale ndaj gazetarëve, ndërkohë po aq janë raportuar edhe në vitin 2021. Gjithsesi, shumica e rasteve të raportuara për vitin 2022 kishin të bënin me ndalimin pa shkak nga Policia dhe pengesa të tjera ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias gjatë raportimit drejtpërdrejtë nga protestat. Ndërsa në vitin 2021, sulmet aktuale lidhen më shumë me individë privatë.

Në vitin 2022, gazetarët në Shqipëri u përballën me forma të ndryshme dhune dhe ngacmimesh, përfshirë këtu sulme fizike dhe pengim të punës së tyre. Këto raste nxjerrin në pah vështirësitë dhe rreziqet që hasin gazetarët gjatë kryerjes së detyrës. Disa raste të njohura janë Simon Shkreli, gazetar i TV Roza dhe ABC News, të cilit iu tha nga një efektiv policie të ndalonte filmimet ndërkohë që ishte me fëmijët e tij në Shkodër. Gjatë një proteste jashtë selisë së Partisë Demokratike në Tiranë, gazetarët dhe ekipet e mediave u bënë në shënjestër e autoboteve ujëshkarkues të policisë dhe u spërkatën me gaz lotsjellës. Gazetari Sami Curri u shoqërua në Komisaratin e Bulqizës pas një proteste kundër rritjes së çmimit të naftës dhe ushqimeve. Adriatik Doçi u sulmua fizikisht nga persona të paidentifikuar në Tiranë dhe një 62-vjeçar u arrestuar pasi kishte sulmuar fizikisht një gazetare në Korçë. Në përleshjet mes policisë dhe tifozëve të futbollit, fotografit Gent Shkullaku iu sekuestrua aparati fotografik. Gazetarët që mbulonin protestat kundër rritjes së çmimeve në qytete të tjera në vend u përballën me kërcënime dhe sulme fizik nga efektivë të policisë. Edhe gazetari Ledio Guni u dëbua me dhunë nga policia teksa dokumentonte shembjen e banesave të banorëve në Lagjen "5 Maji", ndërsa gazetaria Sonila Musai u tërhoq zvarrë me dhunë nga policia ndërkohë që raportonte për qëndresën e banorëve kundër prishjes së banesave të tyre në Tiranë. Këto incidente theksojnë nevojën për rritjen e masave për mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve në Shqipëri.

Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve

Pikët për 2021: 3,84 / Pikët për 2022: 3,84

Për shkak të vështirësive të vazhdueshme, mjedisi për gazetari cilësor, të pavarur dhe vëzhguese në interes të publikut në Shqipëri mbetet mjaft i rrezikuar. Këto vështirësi burojnë nga një sërë problemesh strukturore, përfshirë këtu marrëdhëniet simbiotike mes politikës, biznesit dhe medias, përqendrimi në pak duar i pronësisë së mediave, mungesa e transparencës së burimeve të financimit, përdorimi i mediave për shantazh, konflikti i interesave, pluraliteti i kufizuar i medias, aksesit i kufizuar në informacion, rënia e cilësisë së përmbajtjes që jepet nga mediat, rritja e disinformimit, dhe përkeqësimi i kushteve të punës dhe i të drejtave në punë.

Në janar të vitit 2022, disa media shqiptare online, si dosja.al, syri.net, faktor.al, SportExpress, Lapsi.al, ndër të tjera, kanë raportuar sulme kibernetike që dyshohet se janë urdhëruar nga kryebashkiaku Erion Veliaj, pasi këto media kanë publikuar një regjistrim audio të Veliajt ku ky i fundit përdorte gjuhë kërcënimi dhe fjalor banal si presion për të zgjedhur njeriun e tij në krye të organit drejtues të futbollit në vend. Pretendohet se këto sulme kibernetike lidhen me kritikën e vazhdueshme ndaj qeverisë dhe kryebashkiakut Veliaj, i cili ka pranuar se regjistrimi audio është autentik, por nuk ka deklaruar në lidhje me sulmet kibernetike. Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt ka bërë thirrje që të ndërmerret një hetim për këtë çështje.

Titulli në origjinal
Treguesi i Nivelit të Sigurisë së Gazetarëve në
Ballkanin Perëndimor
Raporti përshkrues për Shqipërinë 2022

Botues
Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë



Autore
Blerjana Bino

Eksperte ligjore
Erida Skëndaj

Eksperte për mediat
Kristina Voko

Përktheu në shqip
Durim Tabaku

Arti grafik
comma.rs

Ky botim u bë i mundur me mbështetjen
e Bashkimit Evropian dhe Aksionit për të
Drejtat e Njeriut. Përmbajtja e këtij botimi
është përgjegjësi vetëm e Shoqatës së
Gazetarëve të Kosovës dhe nuk pasqyron
domosdoshmërisht qëndrimin e Bashkimit
Evropian dhe Aksionit për të Drejtat e Njeriut.

